



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM

Prot.

Përmet, 14/02/2025

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Përmet

I nderuar këshilltar.

Ju njoftoj se ditën e Martë datë **18.02.2025** ora **11:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së Mbledhjes
2. P/V: "Për miratimin e raportit të monitorimit të buxhetit dhe vlerësimin e përgjithshëm financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2024, Bashkia Përmet".
P/V: "Për disa shtesa në VKB nr. 107 datë 18.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Përmet viti 2025".
3. P/V: "Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për dhënie ndihmë financiare".
4. P/V: "Për miratimin e listës së ngastrave pyjore dhe kullusore të gatshme për tu dhënë në përdorim për kullotë për 2025-2026.
5. P/V: " Për miratimin e rinovimit të kontratës së qerasë Nr. 1642 Prot, datë 04.07.2018 e emërtuar si "Site 1216 Petran" për dhënie me qera të sipërfaqes 20 m të pasurisë me nr 396 ekonomia pyjore Petran ku është vendosur antenë fikse e telefonisë celulare Vodafone Albania".
6. P/V: "Për ndryshimin në VKB Nr. 114 Dt 18.12.2024, "Për miratimin e masës së qerasë mesatare të apartamenteve në tregun e lirë për vitin 2025 në Bashkinë Përmet".
7. P/V: "Për vendosjen e një pllakade në rrugën "At Stath Melani" në lagjen historike të Përmetit".
8. P/V: " Për miratimin e menuve dhe kuotave ushqimore për ofrimin e vakteve ushqimore në kuadër të projektit "Përfaqimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë".
9. P/V: " Për kalimin e listës së individëve përfitues në projektin "Përfaqimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë".
10. P/V: " Për miratimin e memorandiumit të mirëkuptimit për bashkëpunimin ndërkufitar AOOS-VJOSA".
11. P/V: " Për miratimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë muaji Shkurt 2025".
12. P/V: "Për Miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmës ekonomike deri në 6%".
13. Raport për veprimtarinë e Këshillit të Bashkisë për vitin 2024 dhe transparencën në procesin e vendimarrjes".
14. Të tjera...

Kryetari i Këshillit të Bashkisë Përmet

Anila DHIMITRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

Nr 442 prot

Përmet, 14 / 02 / 2025

Lënda: Dërgohet dokumentacion për shqyrtim dhe miratim

Znj Anila Dhimitri

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK PËRMET

E nderuar Zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimet, relacionet shoqëruese si dhe dokumenta të tjerë shoqërues si më poshtë:

1. Miratimin e Raportit të Monitorimit të Buxhetit dhe Vlerësimin e Përgjithshëm Financiar për Periudhën Janar-Dhjetor 2024, Bashkia Përmet
2. Disa Shtesa në VKB NR 107 Datë 18.12.2024. Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Përmet Viti 2025
3. Miratimin e Përdorimit të Fondit Rezervë për Dhënie Ndihmë Financiare
4. Miratimin e Listës së Ngastrave Pyjore dhe Kullusore të Gatshme për tu Dhënë në Përdorim për Kullatë Për 2025-2026.
5. Për Miratimin e Ndihmës Ekonomike Për Familjet në Nevojë Muaji Shkurt 2025.
6. Për Miratimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok Ndihmës Ekonomike deri në 6%.
7. Për Vendosjen e Një Pllakade në Rrugën "At Stath Melani" Në Lagjen Historike të Përmetit.
8. Për Ndryshimin në VKB Nr 114 Dt 18.12.2024. Për Miratimin e Masës së Qerasë Mesatare të Apartamenteve në Tregun e Lirë Për Vitin 2025 Në Bashkinë Përmet.

9.Për Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëpunimin Ndërkufitar AOOS-VJOSA.

10.Për Miratimin e Rinovimit të Kontratës së Qerasë Nr 1642 Prot, date 04.07.2018 e emërtuar si “Site 1216 Petran” për dhënien me Qera të Sipërfaqes 20m të pasurisë me nr 396 Ekonomia Pyjore Petran ku është vendosur Antenë Fikse e telefonisë Celulare Vodafone Albania

11.Për Miratimin e Menuve dhe Kuateve Ushqimore,për Ofrimin e Vakteve Ushqimore në Kuadër të Projektit “Përqaftimi I Shpresës Një Oaz Për Ata Që kanë Nevojë”

12.Kalimi I Listës Së Individëve Përfitues Në Projektin Përqaftimi I Shpresës Një Oaz Për Ata Që kanë Nevojë”

Me respekt,

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

A blue circular official stamp of the Municipality of Permet, Republic of Albania. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top and "P-BASHKIA PËRMET" at the bottom. In the center, there is a smaller emblem of the Republic of Albania. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink, which appears to be "Alma Hoxha".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ datë ____ / ____ 2025

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË BUXHETIT DHE VLERËSIMIN E
PËRGJITHSHËM FINANCIAR PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2024 ,BASHKIA PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”,i ndryshuar, neni 48 “ Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit vendor”, Ligji nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” , Udhëzim nr.1 datë 24.01.2024 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024” Udhëzim nr.35 datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetqeverisjes vendore”,Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:


1. Të miratojë raportin e monitorimit të Buxhetit dhe vlerësimin e përgjithshëm financiar , për periudhën 12-mujore,viti 2024,për Bashkinë Përmet.
2. Ky vendim shpallet menjëherë dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA





RAPORTIM I ZBATIMIT TE BUXHETIT TE VITIT 2024 (JANAR-DHJETOR) BASHKIA PERMET



1

1

1

1

1

1



Buxheti i Bashkisë për Vitin 2024.

Detajimi i buxhetit për vitin 2024, është bere bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 "Per inancat e veteqeverisjes vendore", ligjin 97/2023 " Per buxhetin e vitit 2024 " ,miratuar me VKB nr.97 date 8.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024, të Bashkisë Permet ",me ndryshime .

Programi Buxhetor i vitit 2024,parashikonte, një mbulim sa më të plotë ,të territorit, me shërbime publike cilësore me qellim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimi të biznesit; ndërtimin e investimeve , reabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; përmirësimin e sistemit të edukimit , sigurimin e kushteve sa më dinjitoze për fëmijët dhe të rinjtë mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Permet;

Ky dokument ka përcaktuar 6 programe dhe një seri funksionesh dhe aktiviteteve respektive për çdo funksion, prandaj është treguesi më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara të dhe me Strategjinë e Zhvillimit dhe Planet Vendore që i mbështesin këto projekte.

Bashkia Permet, administron dhe menaxhon fondet, sipas 6 programeve të miratuara, të listuar sipas funksioneve dhe te permbledhura si me poshte me poshtë:

- ❖ AA135 Planifikim, Menaxhim dhe Administrim.
- ❖ AB135 Zhvillim i komunitetit (Pastrim Gjëlberim)
- ❖ AB135 Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitje
- ❖ AB135 Administrimi i Pyjeve
- ❖ AB Rruge Rurale
- ❖ AB135 Menaxhimi i mbetjeve
- ❖ AB135 Planifikimi i territorit

- ❖ AC135 Perfshirja sociale +Projekti KEY-PEOPLE
- ❖ AC135 Arsimi i mesem,konviktet
- ❖ AC135 Arsimi baze dhe parashkollor

- ❖ AC135 Kujdesi dhe femijet (Cerdhet)
- ❖ AD135 Sporti
- ❖ AD135 Kultura +Projekti ARCH

- ❖ AE135 Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri
- ❖ AE135 Mbrojtja dhe siguria e qytetarit

- ❖ AF135 Transfera te individe, institucione ,organizata
- ❖ AF135 Fond rezerve
- ❖ AF135 Fond emergjence



Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2024, vijnë nga 3 burime:

1. **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore të miratuara në paketën fiskale të Bashkisë Permet me VKB nr.75,dt.30.10.2023, të ardhura të tjera nga donatorët dhe të ardhura që trashëgohen nga viti 2023.
2. **Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike sektoriale për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë, Transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale specifike të trashëguar dhe transfertat e kushtëzuar.
3. **Fonde të BE dhe organizata të tjera jo fitim prurëse .**

I. Realizimi i të ardhurave të Bashkisë nga burimet e veta vendore për 12-mujorin 2024.

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat e veta, taksat e ndara, tarifat vendore, të ardhurat e tjera . Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjatë 12/mujorit të vitit 2024, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

ëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimit nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe rajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë.

Politikat e ngjashme për tu gjendur sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e ejuar ligjor për tokën bujqesore, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojnë etj, janë batuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të famijleve dhe reduktimin e papunësisë,por edhe për vetë rritjen e të ardhurave nga viti në vit.

Objektiv i rëndësishëm ka qenë përditësimi i vazhdueshëm i regjistrave dhe kapaciteteve fiskale duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye, në bashkëpunim me Njësitë Administrative u koordinuan strukturat e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime të vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave me efekt arritjen e rezultate të mira në zërat kryesore të të ardhurave kryesisht kjo për taksën e ndertesës pasi ishte viti I para I implementimit të ndryshimit të saj. Paralelisht janë ndjekur procedurat e njoftimit brenda afatit, me vijimin e masave shtrenguese për subjektet debitore.

si rezultat i masave të marra, si dhe i sensibilizimit të vazhdueshëm të taksapaguesve, të ardhurat janë realizuar duke përmbushur pritshmëritë e planifikuara,.

Gjithashtu përgjatë periudhës është siguruar për afrimi i planit me nivelet e arkëtimit, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

Të ardhurat e veta u realizuan në proces dhe bashkëpunim me gjithë administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet si agjentë tatimorë, institucionet shtetërore etj.



/ijimi i këtij procesi bashkëpunues do mundësojë më tej sigurimin e të ardhurave për përmirësimin e vazhdueshëm të hërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të jëndrueshëm të të gjithë territoritë bashkisë.

Kategorizimi i të ardhurave

- Taksat vendore:
 - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
 - Taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja
 - Taksa e fjetjes në hotel
 - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
 - Tatim i thjeshtuar mbi fitimin, biznes i vogël nga 5 milion deri ne 8 milion.

- Taksat e ndara
 - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë,
 - Taksa vjetore e mjeteve të përdorura,
 - Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
 - Të ardhura pjesore nga tatimi mbi të ardhurat personale.

- Tarifat vendore
 - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
 - Tarifa për ndriçimin publik
 - Tarifa për gjelbrimin
 - Tarifa të shërbimit administrative të bashkisë Permet.
 - Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
 - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
 - Tarifa për zënieën e hapësirave publike
 - Tarifa nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.

- Të ardhura të tjera:
 - Të ardhura nga gjoba
 - Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhdëmtime, shitja e mallrave dhe e shërbimeve etj.

- Donacione/Sponsorizime

Të ardhurat nga burimet e veta vendore të Bashkisë, 12 mujori i vitit 2024

000/lekë

Të ardhurat nga burimet e veta		Plan	Realizimi 12-	Realizimi
№	vendore	12-mujor 2024	mujori 2024	% 12-mujor
1	Të ardhurat nga taksat vendore	24,474	24,404	99,7 %
2	Të ardhurat nga tarifat vendore	33,679	31,100	92,3%
3	Te ardhura nga donacionet ,etj.	2,423	2,423	100%



Te ardhura nga grande e			
4. rimbursime .	3,745	3,745	100%
TOTALI	63,370	61,672	97,3%

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për 12/mujorin e vitit 2024 u realizuan në vlerën 61,672 mijë Lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat, nga taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat dhe të ardhurat nga burime të tjera. Është i detajuar arketimi i të ardhurave sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si me poshte :

LLOJET E TË	ARDHURAVE	Plan viti 2024	Realizimi	Krahasimi në
			Janar-Dhjetor 2024	% me planin Dhjetor 2024
A	TË ARDHURAT E VETA	58153	55504	95%
A.I	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	24474	24404	100%
I.1	Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për BV	0	153	
I.1.0	Të ardhura nga taksa mbi BV			
I.2	Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	12636	10899	86%
I.2.1	Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	9880	7418	75%
I.2.1.1	<i>Ndërtesa banimi</i>			
I.2.1.2	<i>Ndërtesa të tjera</i>			
I.2.2	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	1816	1980	109%
I.2.3	Të ardhura nga taksa mbi truallin	940	1501	160%
I.3	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	110	290	264%
I.4	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë	3200	1331	42%
I.5	Të ardhura nga taksa e tabelës	300	301	100%
A.II	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	8228	11430	139%
II.1	Të ardhura nga taksa vjetore e qarkullimit të mjeteve	4637	6283	135%
II.2	Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	250	97	39%
II.3	Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
II.4	Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale	3341	5050	151%
A.III	TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	33679	31100	92%
III.1	Te ardhura nga tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave	13220	14331	108%
III.1.1	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje			
III.1.2	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione			



III.1.3	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi			
III.2	Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	4550	4037	89%
III.1.1	Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje			
III.1.2	Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Institucione			
III.1.3	Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi			
III.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	1970	1962	100%
III.1.1	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje			
III.1.2	Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione			
III.1.3	Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi			
III.5	Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ	5190	4096	79%
III.1.1	Nga tarifa administrative, kontroll territorit, AMTP, etj.			
III.1.2	Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të therura			
III.1.3	Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit	1800	1094	61%
III.1.4	Nga tarifa parkimi për mjetet	250	60	24%
III.1.5	Nga tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës			
III.1.6	Nga tarifatat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	2040	1719	84%
III.1.7	Nga tarifatat e shërbimeve që kryen struktura e MNZ	250	45	18%
III.1.8	Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	850	1178	139%
III.1.9	Nga linjat ajrore dhe nëntokësore			
III.1.10	Nga dokumentat për tender, ankand etj.			
III.1.11	Nga tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj	1500	1831	122%
III.1.11.	<i>Pallati sportit</i>			
III.1.11.	<i>Nga kopshtet</i>	1500	1831	122%
III.1.11.	<i>Nga çerdhet</i>			
A.IV	TË ARDHURA TË TJERA	7249	4843	67%
IV.1	Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)			
IV.2	Të ardhura nga dhënia me qira		0	
IV.3	Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime		0	
IV.4	Të ardhura nga qera per troje	5370	2818	52%
IV.7	Të ardhura te tjera	1879	2025	108%




	Detyrimet ujesjellesi	24811	0	
A.V	TË ARDHURA NGA DONACIONET	2423	2423	100%
	total	60576	57927	96%
kap.1	Rimbursim shpenzimesh	2794	2794	100%
kap.5	Grande nga institucione nderkombetare	951	951	100%

Niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin me afrimin e afatit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi, si dhe ndjekjes së masave shtrënguese ndaj subjekteve debitore, si dhe derdhjeve të bera nga SH.A Ujesjelles Permet.

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e realizimit të të ardhurave në lidhje me planin 12/mujor për kategoritë e taksave, aksave të ndara, tarifave dhe të ardhurave të tjera në lidhje.

GRAFIKU I TE ARDHURAVE

■ Plan ■ Realizim



	Të ardhura nga taksat	Të ardhura nga taksat e ndara	Të ardhura nga tarifat	Te ardhura nga donacionet
Plan	16,246	8,228	33,679	2,423
Realizim	12,974	11,430	31,100	2,423



III. Realizimi i buxhetit te 12-mujorit 2024


Realizimi i buxhetit te vitit 2024, eshte bere duke respektuar nenin 64 te ligjit 139/2015 “ Per veteqeverisjen vendore “, ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar , ligjin 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore “, ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, udhezimin nr. 22 date 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit te njesive te qeverisjes vendore” , udhezimin nr.9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” , udhezimin plotesues të Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 1 dt. 24.01.2024“Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024” ; ligjin 97/2023“Per buxhetin e vitit 2024” dhe VKB nr.97,dt 18.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025-2027, të Bashkisë Permet”

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, të realizuara ne 12 M e vitit 2024 ,nga ate gjitha burimet e financimit, arritën në 544,544 mije leke ,me një nivel realizimi prej 70%.

I detajuar realizimi i shpenzimeve paraqitet si me poshte :


mije leke			
NR.	EMERTIMI	PLANI	FAKTI
1	Paga dhe Sigurime	243228	229558
2	Shpenz.Operative	86530	65831
3	Transferime	15536	10649
4	Investime	175619	74398
5	Paga dhe sigurime	5532	4554
6	Shpenzime Operative	0	0
7	Transferime	90208	88764
8	Investime	93093	69399
	Totali	709746	543153
76.5%		Kap.6	2980
		Kap.2	1391
			65140

Realizimi i shpenzimeve me te gjitha burimet e financimit ne mije leke





Realizimi i shpenzimeve me te gjitha burimet e financimit ne %



Shpenzimet per paga rreth 94.4% jane realizuar me burim financimi Burimet e Veta dhe me Transferte Specifike,dhe 2.3% me Transferte te Kushtezuar.

Shpenzimet Operative rreth 76% jane realizuar me Burimet e veta dhe me Transferte Specifike

shpenzimet per transferime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 98,4%.

shpenzimet per investime rreth 42,4% jane realizuar me Burimet e Veta ,transferte specifike.

shpenzimet per transferime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 98,4%.

shpenzimet per investime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 74,5%.

- Transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore

Te ardhurat e veta përfshijnë transferten e pakushtezuar, te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe te ardhura nga burime te tjera. Këto burime të ardhurash, jane burimi kryesor i buxhetit te bashkise dhe zene 34 % te totalit te buxhetit te planit te pergjithshem .Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 39/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë vitit 2024 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhon burimet e veta dhe siguron të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

- Transferta specifike

Ne vitin 2024 bashkia vazhdon te kryeje funksionet e transferuara me burim financimi transferten specifike.

Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2024, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit

parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar.

Për Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve/punonjës mbështetës, janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 33 punonjës të transferuar,si dhe shpenzime



operative ne vleren 39,645 mije leke .Bashkia Permet per nje cilesi me te mire ne kete sherbim nga te ardhurat e saj ka shtuar fonde per shpenzime operative per mirembajtjen e objekteve mesimore e ushqimet ne kopshtet me lreke ne vleren 1,852 mije leke .

- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)

Në transfertën specifike te vitit 2024, janë fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Në këto fonde bëjnë pjese fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Shuma e alokuar bashke me transferten e trashëguar per vitin 2024,eshte 36,134 mijë lekë, numri i punonjësve 14.

Rrugët rurale

Në transfertën specifike të vitit 2024, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Për këtë funksion për vitin 2024,i janë alokuar 8,397 mijë lekë. Bashkia Permet per nje cilesi me te mire ne kete sherbim nga te ardhurat e saj ka shtuar fonde per paga e sigurime shoqerore per punonjes dhe shpenzime operative dhe investime ne vleren 86,688 mije leke .

- Administrimi i pyjeve

Në transfertën specifike te vitit 2024, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond perfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.Për këtë funksion për vitin 2024 janë alokuar 9,392mijë lekë, numri i punonjësve është 7.Bashkia Permet per nje cilesi me te mire ne kete sherbim nga te ardhurat e saj ka shtuar fonde per paga e sigurime shoqerore per 7punonjes ne vleren 4,674 mije leke .

- Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën specifike të vitit 2024, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond perfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative dhe investime .Për këtë funksion për vitin 2024 i janë alokuar 9,055 mijë lekë, numri i punonjësve është 2. Bashkia Permet per nje cilesi me te mire ne kete sherbim nga te ardhurat e saj ka shtuar fonde per paga e sigurime shoqerore per 7 punonjes ne vleren 1,123 mije leke .

- Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2024, Bashkisë Permet i janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë ishin te përfshira; fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime. Fondi i alokuar për këtë funksion per vitin eshte 17,632 mije leke .

Realizimi i transfertes specifike ne total paraqitet si me poshte:



Struktura	Paga		Sigurime		Shpenzime		Investime	Total PLAN	Total Fakt	
	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT				plan
Arsimi pergj	28374442	26075736	4612000	4312033	4029000	4029000	700000	209542	37715442	34626311
Ars.mesem	3702000	3511856	609000	595308	1020000	1020000	982000		6313000	5127164
konvikti	4516000	4379566	721000	721000	5882000	1062719	200000		11319000	6163285
zjarrfiksja	16557639	16205064	2692000	2632273	4696000	2385876	4136000		28081639	21223213
RRUGET	7266000	7266000	1131000	1131000					8397000	8397000
Pyjet	4355000	4267767	693000	693000	3528976	1882202	816024	726000	9393000	7568969
Bordi kull.	1657000	1090250	264000	188520			7134752	1684567	9055752	2963337
sporti							65000000	40089566	65000000	40089566
M.Mbetjeve					7430000	5211739	7681000	1850400	15111000	7062139
TOTAL	66428081	62796239	10722000	10273134	26585976	15591536	86649776	44560075	190385833	133220984

Detyrimet e prapambetura të bashkisë Permet, te trashguara nga zbatimi i Reformes Territoriale

sipas përcaktimit në Udhëzimin e Ministrisë së Financave, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet inanciare të përcaktuara nga një ligj/kontratë /marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të rapaguara 60 ditë pas datë së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të htyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Procedura,eshte në zbatim të reformës territoriale VKM nr 510, datë 10.06.2015 " Për miratimin e procedurave për ransferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo lokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territoriale"

Bashkia Permet raporton në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për cdo tremujor për keto detyrime të prapambetura,ne fundin e muajit pasardhes.

Detyrimi i mbetur ne periudhen raportuese është 2,648,974 leke, nga këto janë 2,346.886 lekë detyrime për shlyerje të prapambetura para vitit 2007 energji elektrike .Bashkia Permet eshte ne proces gjyqesor me FSHU,per nosnjohje te detyrimit .Detyrim për vendime gjyqesore të palikuiduara 302,088 leke .

Raporti për periudhën Janar -Dhjetor viti 2024 ,për detyrimet e prapambetura paraqitet sipas tabelave me poshte :

1- Situata financiare

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësi e vetëqeverisjes vendore			
Situata Normale e gjendjes fiannciare	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare
		Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%
Situat Normale e gjendjes financiare	0	0	0

2- Vlera e detyrimeve në raport me buxhetin paraqitet në tabelën me poshte :



Muaji Janar- Dhjetor 2024

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	2,648,974		0.70%
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	302,088		
4864200	Det.Prap. Sherbine			
4864201	D.P.Energji Elektrike	2,346,886		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime			
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronetime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	2,648,974	380,436,250	0.70%

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2023, vitin paarrës dhe vitin 2024 viti aktual paraqitet si më poshtë:



Programet		Shpenzimet e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
Titulli	Emertimi	Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
		i vitit paraardhes Viti 2023	Viti 2024	Plan Fillestar Viti 2024	Plan i Rishikuar Viti_2024	Plani i Periudhes/ progresiv	i Periudhes/progr esiv	
AA135	Administrim,menaxhimi	76,569.0	63,393.0	78,881.0	4,587.0	83,468	75,558	7,910.0
AB135	Sherbimet publike komunitre dhe infrastrukture	162,704.0	144,384.0	221,072.0	-6,510.0	214,562	141,761	72,801.0
AC13	Arsim dhe kujdesi social	83,286.0	92,763.0	82,156.0	6,895.0	89,051	67,825	21,226.0
AD135	Argetim dhe Zhvillim	19,829.0	15,781.0	92,930.0	250.0	93,180	63,014	30,166.0
AE135	Siguria e qytetarit dhe mbrojtja e mjedisit	18,611.0	24,788.0	34,062.0	2,072.0	36,134	29,262	6,872.0
AF135	Rezerva dhe kontigjenca	1,381.0	3,681.0	4,120.0	400.0	4,520	3,016	1,504.0
								0.0
								0.0
								0.0
								0.0
								0.0
								0.0
								0.0
								0.0
								0.0
								0.0
								0.0
Totali i Shpenzimeve të Njesisë			344,790.0	513,221.0	7,694.0	520,915.0	380,436.0	140,479.0
Totali		362,380.0	344,790.0	513,221.0	7,694.0	520,915.0	380,436.0	140,479.0
Kryetari i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore			Emri	Alma HOXHA				
			Firma					
			Data					

Për detajuar shpenzimet sipas programeve buxhetore dhe funksioneve të këtyre programeve paraqiten si më poshtë:

❖ AA135 Planifikim, Menaxhim dhe Administrim.

1. Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

Iyrje

Politikat e zhvillimit

Qeverisja jonë lokale do të bazohet në parimet e sundimit të ligjit, përgjegjësisë, llogaridhënies, besimit, transparencës, efektivitetit, efikasitetit, partneritetit dhe koherencës.



Meqënëse qeverisja e mirë ndërlidhet me aftësinë e Bashkisë për të siguruar shërbimin më të mirë për komunitetin, çdo nëtar është aktiv për të dhënë kontributin e tij. Prandaj, për ne ekziston një nevojë e vazhdueshme që Bashkia të veprojë i lehtësuese duke iu prirë qytetarëve:

- drejt të menduarit strategjik,
- duke i përfshirë ata në çështjet e pushtetit lokal,
- duke i bërë partnerë në zgjidhjen e problemeve.

Politikat e vazhdueshme, e cila do të zbatohet nga administrata e bashkise së Permetit do të jenë:

I. Një strukturë menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësi dhe lehtësi për perthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

FF. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.

CCC. Dixhitalizmi i administratës publike është dhe do të mbetet një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore

Ne jemi të angazhuar për të shtuar dhe promovuar shërbimet elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore.

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2 paraqiten sipas tabelës me poshtë :

Bashkia	Permet						Kodi i Grupit / Njesisë Vendore
Programi	AA135						Kodi i Programit
Art.	Emertimi	-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2023	-2 PBA Plan Viti 2024	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	-5 Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	-6 Fakti i Periudhes/progresiv

600	Paga	44316	36129	41806	1350	43156	41062
601	Sigurime Shogërore	7407	7264	6649	550	7199	6804
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	24629	20000	25909	2687	28596	27469
603	Subvencione				0		
604	Transferta Korente të Brendshme				0		
605	Transferta Korente të Huaja				0		
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	172			0		0
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	76524	63393	74364	4587	78951	75335
230	Kapitale të Patrupëzuara				0		
231	Kapitale të Trupëzuara	45		4517	0	4517	223
232	Transferta Kapitale				0		
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	45	0	4517	0	4517	223
230	Kapitale të Patrupëzuara				0		
231	Kapitale të Trupëzuara				0		
232	Transferta Kapitale				0		
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				0		
Totali	Shpenzime Kapitale	45	0	4517	0	4517	223
Totali (korrente + kapitale)		76569	63393	78881	4587	83468	75558
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Kryetari Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri			
	Firma			Firma			
	Data			Data			

Realizimi i shpenzimeve për programin

P1. Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim).

Deri me datë 31.12.2024 janë likuduar në total 75,558 mijë lekë nga këto: paga dhe sigurime shoqërore 47,866 mijë lekë , shpenzime operative në shumën 27,469 mijë lekë, investime në shumën 223 mijë lekë,Transferta te punonjesit 0 leke



Programi P1	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 12-mujor 2024	50,355	28,596		4,517	83,468
Realizimi 12-mujori 2024	47,866	27,469		223	75,558

❖ AB135 Zhvillim i komunitetit (Pastrim Gjelberim)

2. Infrastruktura Rrugore

Iyrje

Çrijimi i territorit të ri administrativ të bashkisë është duke përfshirë qytetin e Permetit dhe fshatrat e 4 njësi administrative të tjera në programin e infrastrukturës rrugore si funksion i veti do të jetë ndërtimi, mirëmbajtja dhe çhabilitimi i rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike të tij.

Politikat e zhvillimit

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses në të mirë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Programi i infrastrukturës rrugore, bazohet në 2 politika themelore :

- Përmirësimin e mjedisit urban dhe rural me standartet e duhura në shërbim të komunitetit.
- Rritjen e cilësisë së jetës së banorëve.

Bashkia	Permet							Kodi i Grupit / Njesisë Vendore
Programi	AB135							Kodi i Programit
Art.	Emertimi	-1 Fakti i vitit paraardhes Viti 2023	-2 PBA Plan Viti 2024	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti_2024	-5 Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progresiv	-6 Fakti i Periudhes/progresiv	
600	Paga	68035	77017	78670	550	79220	74443	
601	Sigurime Shoqërore	11287	14989	12512	250	12762	12304	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	22703	29318	29985	-1124	28861	21583	
603	Subvencione				0			
604	Transferta Korente të Brendshme	251			0			
605	Transferta Korente të Huaja				0			
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			0	0			
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	102276	121324	121167	-324	120843	108330	
230	Kapitale të Patrupëzuara		1000	7000	0	7000	6436	
231	Kapitale të Trupëzuara	60427	22060	92905	-6186	86719	26993	
232	Transferta Kapitale				0			
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	60427	23060	99905	-6186	93719	33429	
230	Kapitale të Patrupëzuara				0			
231	Kapitale të Trupëzuara				0			
232	Transferta Kapitale				0			
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	
Totali	Shpenzime Kapitale	60427	23060	99905	-6186	93719	33429	
Totali (korrente + kapitale)		162703	144384	221072	-6510	214562	141759	



Drejtuksi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Kryetari Njesisë Vetëqeverisjes Vendore	Emri		
	Firma		Firma		
	Data		Data		

Për vitin 2024, janë përcaktuar objektiva të qartë për punën tonë në përmbushje të detyrave funksionale. Këto objektiva janë dakordësuar me organizatat e shoqërisë Civile, Institucionet në varësi të Bashkisë Permet ,

Funksionet:

F1. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, shesheve publike vendore;urave etj

F1.O1.Mirëmbajtja e rrugëve dhe shesheve urbane;

Situata e synuar 2024 Objektivat	Realizimi i objektivave 12-mujori 2024	Realizimi i produkteve 12 – mujori 2024
Kryerja e punimeve të mirëmbajtjes së rrugëve dhe shesheve në Qytet,ne NJA mirembajtje urash etj.	Janë kryer punime mirëmbajtje të rrugëve si me poshtë:	Është përfunduar faza e punimeve për mirëmbajtjen e rrugëve rurale dhe shesheve të qytetit

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

Aktiviteti Buxheti ne mije leke Realizimi 12-mujori 2024
në mijë

PL.F1.O1.A1 Mirembajtje rruge rurale ne NJA fonde te trasferuara ,

3,390 2,959

U sistemuan 180 km rruge rurale ne te 4 Njesite Administrative ,duke nderhyre me te gjitha mjetet e renda .Vlera e mesiperme eshte vlera per



karburant qe eshte harxhuar per
sistemimin e rrugeve .



F1.O2. Rikonstruksion rrugë dhe sheshe urbane

Situata e synuar 2024 Objektivat	Realizimi i objektivave 12-mujori 2024	Realizimi i produkteve 12 – mujori 2024
Sistemim asfaltim rruge te ndryshme te fshatrave Kutal,Kosine ,Zhepe,Dracove,etj.	<ul style="list-style-type: none"> • Jane mbyllur punimet sipas kontrates se lidhur me firmen fituese”Hito-94” 	Jane realizuar punimet e percaktuara ne objektiv.
Sistemim asfaltim rruga e fshatit Qilarisht	Ne procedure prokurimi	

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2

Aktiviteti	Buxheti në mijë	Realizimi 12-mujori IV-rë 2024
	lekë	në mijë lekë
P3.F1.O2.Sistemim Asfaltim në rruge te ndryshme te qytetit dhe NJA	13,196	13,196
P3.F1.O2.Sistemim Asfaltim rruga e spitalit Varezat publike	9,437	9,437



F1.O4. Permiresimi i rrjetit te rrugeve rurale duke siguruar lidhjen e te gjitha qendrave te banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombetar.

Situata e synuar 2024	Realizimi i objektiveve 12 - mujori 2024	Realizimi i produkteve 12 – mujori 2024
Objektivat		
Mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të bashkisë.	Në proces zbatimi	Në proces zbatimi
Përmirësim i infrastrukturës rrugore si dhe rritje e aksesit ndaj shërbimeve bazë në zonat rurale.	Identifikimi i problematikave në Nj.A Hartim i i preventivave, dokumentacionin teknik dhe plani i ndërhyrjeve, për realizimin e procedurave të prokurimit	
Reduktim i kostove për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes nëpërmjet rritjes së kapaciteteve teknologjike dhe përdorimit të fuqisë punëtore të njësisive administrative. Mirëmbajtja e 180 km rruge, Numri i rrugëve në Njësi Administrative		

Realizimi i shpenzimeve për programin P2. Infrastruktura Rrugore 000/lekë.

Programi P2	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 12-mujor 2024	20,795	3,390	0	70,900	95,085
Realizimi 12-mujorit të 2024	19,758	2,959	0	29,168	51,885



P3. Shërbimet Publike

1. Hyrje

Programi i ofrimit të shërbimeve publike qytetarëve, bizneseve dhe të gjithë komunitetit në të gjithë territorin administrative të Bashkisë përbën një nga kolonat kryesore të programit buxhetor. Ky program përmban shërbimet më jetike për komunitetin siç janë:

- a) mirëmbajtja dhe administrimi i sipërfaqeve të gjelberta,
- b) mirëmbajtja e varrezave publike dhe krijimi i kushteve sipas standartave për shërbimin funeral,
- c) mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara,
- d) shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike,

Shërbimet publike, për nga rëndësia e tyre, ndikojnë direkt në cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe janë një parakusht për zhvillimin social ekonomik për të gjithë territorin e Bashkisë Permet.

2. Politikat e zhvillimit

Programi i shërbimeve publike, bazohet në tre politika themelore :

- a) Ofrimi i shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.
- b) Rritja e efiçensës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të shërbimit.
- c) Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe të monitorimit, për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre.



Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1.

F. Shërbimin e dekorit publik

F.O1. Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tonë

Situata e synuar 2024 Objektivat	Realizimi i objektivave 12-mujorit 2024	Realizimi i produkteve 12- mujorit 2024
Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbane;	Dekori realizohet në 6-mujorin e II-të, me rastin e festave tradicionale kombëtare dhe të Fundvitit.	Pagese dekori viti aktual

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 12-mujorit 2024 në mijë lekë
P3.F.O1.A1 Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tone,	600	527

F8. Ndrëçimi i mjediseve publike

F8.O1. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit

Situata e synuar 2024 Objektivat	Realizimi i objektivave 12-mujorit 2024	Realizimi i produkteve 12- mujorit 2024
Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e rrugor. shesheve të ndriçuara 55,360 M2.	Eshtë mirëmbajtur i gjithë rrjeti i ndriçimit rrugor në qytete dhe një pjesë e NJA.	Mbajtja në efikasitet të ndriçimit
Sipërfaqet e lulishteve të ndriçuara të ndriçimit të Me investime të reja nga 7,000 m2.	Mirëmbajtje e ndriçimit të lulishteve ekzistuese. Zgjerimi i sipërfaqes në varësi të realizimit të investimeve të reja.	Mbajtja në efikasitet të lulishteve ekzistuese.
Rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndriçimit të lulishteve ekzistuese.		Ura Karburant "Roselia" ❖ Ura Karburant "Kastrati" ❖ Pedonale ❖ Lulishte kryesore ❖ Ura deri te Guri I Qytetit ❖ Rruga kryesore Qender-Guri i Qytetit



Kryqezim
komisariati Permet

Mirembajtje e ndriçuesva të ndriçimit Zakonshem 1,000 ndriçues. materiale vitit.

Mirembajtje e ndriçuesva të zakonshem ekzistues.

Mbajtja në efikasitet të rrugor duke siguruar baze të nevojshme gjatë gjithë

Ofrimi i shërbimit të mirembajtjes ndriçimit se ndriçimit 3 Nj. Administrative dhe ndertimi i linjave të reja me e fshatrave, Badlonje, Bodar, prioritet në zonat e populluara.

Mirembajtje e gjithë rrjetit të ndriçimit rrugor.

Mbajtja në efikasitet

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F8.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 12-mujorit 2024 në mijë lekë
P3.F8.O1.A1 Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit	6,600	5,993

Realizimi i shpenzimeve për programin P3. Shërbimet Publike 000/lekë viti 2024

Programi	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
P4						
Plani 2024	29,030	9,895	0	0	7,187	46,112
Realizimi 12- mujorit 2024	28,707	7,591	0	0	0	32,298

P4. Bujqësia, Zhvillimi Rural

Hyrje

Me delegimin e funksioneve të reja Bashkia përmet ka trashëguar kanale ujitëse 63 km, nga këta funksional 32 km dhe jo funksional 31 km, ndërsa kanale kulluese gjithsej 50.5 km nga këto 26 km kanale të para dhe 24.5 km kanale të dyta kullues në pjesën më të madhe të tyre të papastuar prej vitesh. Është rehabilituar dhe 1 km kanal nepermjet fondeve të investimeve të ardhura dy vitet e fundit. Këtë vit u janë shtuar rehabilitimit të veprave ujitëse dhe ndertimi i kanalit ujites Piskove, Rikonstruksion i rezervuarit Pacomit Diga, vepra këto me aftat ndertimi dhe likuidimi brenda vitit 2023-2024. Rikonstruksion i Diga e rezervuarit Qilarisht.

Politikat e zhvillimit

Programi i Bujqësisë, Zhvillimit Rural ka këto politika zhvillimi :



- Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale .
- Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj në për mjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe të kategorive të resurseve të tjera.
- Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës ekzistues,
- Dhe zgjerimi i tyre në te gjithë territorin që mbulon Bashkia Permet.

Funksionet:

F1. Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
 F1.O1. Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit.

Situata e synuar 2024 Objektiva t	Realizimi i objektivave 12- mujori 2024	Realizimi i produkteve 12 - mujori 2024
Fond Rezerve	AF135	V494AAA	01					500000			Fond rezerve



3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet –Financës dhe Drejtoritë e tjera.

4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2025



PËR

DISA SHTESA NË VKB NR. 107 DATË 18.12.2024 “ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË PËRMET VITI 2025”

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë"VKM nr.775 datë 24.09.2010"Per administrimin e financimeve të huaja", Udhëzimi nr.10 datë 12.07.2024 “Për rregjistrimin ,përdorimin,rakordimin,raportimin dhe publikimin e fondeve te financimeve të huaja në kuadrin e marreveshjes nderkombëtare", Ligji 115/2024,"Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit nr. 2 datë 24.01.2025 “ për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, Këshilli i Bashkisë,me propozim të Kryetarit të Bashkise,

VENDOSI:

1.Të shtohen zërat e të ardhurave si më poshtë:

1.1 Të shtohen të ardhurat e mbartura të bashkisë nga viti 2024 në vlerën 12 117 191 lekë

1.2 Të shtohet transferta e pakushtëzuar e mbartur nga vitin 2024 në vlerën 23888634 lekë

1.3 Të shtohet transferta e pakushtëzuar sektoriale nga viti 2024 në vlerën 6983284 lekë

2.Të shtohen shpenzimet në strukturat e mëposhtme:

Strukturat	Programet	Kod Produkti	Kap	600	601	602	604	606	609	230	231	Pershkrim
1110	AA135	V111AAD	05			300000						Kuti dosje standarte per arkivin
1110	AA135	V111AAG	05			2812273						Detyrimet e prapambetura
1110	AA135	V111AAB	01			112671						Pagesa per keshilltar e kryepleq
4260	AB135	V426AAA	01	411031	50000							Paga e sigurime per punonjesit e pyjores
4240	AB135	V424AAB	01	240000	40415	407000						Paga e sigurime dhe materiale speciale per bordin e kullimit
5100	AB135	V510AAA	01	2174861	350000							Paga e sigurime
5100	AB135	P510XXX	01								120000	Blerje dhe vendosje kamera per Fushen e Mbetjeve
6260	AB135	V626AAA	01	3360000	561120							Paga e sigurime per punonjesit
4520	AB135	V452AAA	01	1392000	232464							Paga e sigurime per rruget rurale
4520	AB135	P452AAM	01								9366000	Rikonstrukcion i Rruges Qilarisht
4520	AB135	P452XXX	01							2485358		Studim e Projektme
10430	AC135	P043AAO	05									Bashkëfinacim banesat sociale
10430	AC135	V043AAD	05					432000				Bonus strehimi dhe NE per familjet ne nevoje
9120	AC135	P912AAL	01								315000	Blerje soba per ngrohje
9120	AC135	V912AAB	01			35000						Fiksezjarri

9230	AC135	V923AAB	01			100000						Fikse zjarri dhe hidrant
9230	AC135	V923AAB	01			103836						Aktivitet per festat e 7 Marsit
9230	AC135	P923AAK	01							2008715		Rikonstruksion Konvikti
8130	AD135	V813AAB	05					2000000				Mbeshtetje per sportet me RELOAD
8130	AD135	V813AAB	01			250000	250000					Mbeshtetje per sportet dhe aktivitetet sportive
8130	AD135	P813AAR	05							2061912		Terrene sportive
8130	AD135	P813AAR	01							1708088		Terrene sportive
8220	AD135	V822AAD	01			770000	150000					Pjesmarrje ne takime e panairë dhe aktivite lokale
8220	AD135	P822XXX	01							2237634		Bashkefinansim per rikonstruksion e objekteve perkujtimore (lapidarë)
3280	AE135	V328AAB	01	827426	150000							Paga dhe sigurime per MNZ
4940	AF135	V494AAA	01							500000		Fond rezerve



3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet –Financës dhe Drejtoritë e tjera.

4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRIS

BASHKIA PËRMËT

P/VENDIM

Nr _____ Prot

Datë _____, 2025

Për

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” ,Ligjin Nr. 68 /2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore ”,Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar , Ligji Nr.115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”, Vendimi i KB Nr.107 datë 18.12.2024 “Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2025” dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj” , Vendim Nr. 89, datë 14.02. 2018 Për Miratimin e Kushteve dhe përcaktimin e Rregullave për Transportin Rrugor të Nxënësve të Arsimit Parashkollor, Profesional, Parauniversitar dhe të Studentëve,Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

, Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

V E N D O S I

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara (për dhënie ndihme financiare) në masën 117.000 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë. për sa më poshtë vijon:

1. Violeta Pelushaj	në shumën	15.000	(pesëmbëdhjetë mijë) lekë
2. Muharrem Malkë	në shumën	25.000	(njëzetë e pesë mijë) lekë.
3. Marianthi Qirici	në shumën	20.000	(njëzetë mijë) lekë
4. Flutura Beqo	në shumën	20.000	(njëzetë mijë) lekë.
5. Mina Ballabani	në shumën	25.000	(njëzetë e pesë mijë) lekë

mijë) lekë

6.Fariol Vasil Metko ne shumen 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekë

2. Miratimin e transferimit buxhetor si më poshtë :

Pakësim në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 01,ART 609,Kod Produkti V494AAA në shumën 117 000 lekë

Shtesa në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 01,ART 606,Kod Produkti V494AAA në shumën 117.000 lekë

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Financës dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më 12.02.2025

RELACION
DREJTUAR
KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Shtetësja Violeta Pelushaj ka bërë kërkesë Nr.336 Prot datë 04.02.2025 pranë bashkisë për tu ndimuar financiarisht pasi nënen e ka të sëmurë, e vetmuar ka një vella në burg dhe pergjigjet per te dhe nuk ka mundësi të përballojë shpenzimet për blerjen e ilaçeve dhe shpenzimeve të tjera.

Shtetësi Muharrem Malke banues në fshatin Pacomit kërkon të ndimohet financiarisht nga bashkia me kërkesë Nr.281 Prot datë 23.01.2025 pasi është i sëmurë dhe gruaja i ka thyer kembën e nuk i përballon dot shpenzimet për blerjen e ilaçeve, dhe jemi në gjendje të vështirë ekonomike si familje.

Edhe shtetësja Marianthi Qirici ka bërë kërkesë pranë bashkisë me Nr.273 Prot date 23.01.2025 për tu ndimuar financiarisht ,pasi bashkëshorti i saj është i sëmurë dhe shpenzimet për kurimin e tij janë të mëdha por edhe vete është e sëmurë dhe kërkon të marrë një person për kujdesin e tyre .

Shtetësja Flutura Beqo ka bërë kërkesë me Nr.165 Prot date 20.01.2025 pranë bashkisë për tu ndimuar financiarisht ,pasi është e papunë dhe nuk ka mundësi financiare për të përballuar shpenzimet.

Edhe shtetasi Mina Ballabani banues në fshatin Kosinë ka bërë kërkesë Nr.249 Prot date 27.01.2025 pranë bashkisë për tu ndimuar financiarisht ,pasi është i sëmurë, i papunë, me mjekim për sëmundje kronike, vajza ka bërë ndërhyrje në koke dhe nuk ka mundësi financiare për të përballuar gjithë këto shpenzime.

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” ,Ligjin Nr. 68 /2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore ”,Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligji Nr.115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”.,VKB Nr.107 datë 18.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj,në bazë të kërkesës nga Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “ Meleq

Gosnishti " Përmet Nr.17 Prot datë 28.01.2025 e cila kërkoi të ndimohen nga ana financiare 8 (tetë) nxënësit e zonave rurale që frekuentojnë shkollën,pasi kosto e transoprtit me gjithë rimbursimin nga ZVAP është e papërballueshme, per arsye subjective nje nga keta nxenes nuk eshte perfshire ne listen e miratuar nga bashkia nxenesi Fariol Vasil Metko i cili frekuenton linjen Bodar-Permet- Bodar te rimbursohet per periudhen Janar-Maj viti shkollor 2024-2025

kerkojme qe :

- 1- Violeta Pelushaj të ndimohet përkatësisht në shumën 15.000 (pesëmbdhjetë mijë) lekë .
- 2- Muharrem Malke të ndimohet përkatësisht në shumën 25.000 (njezete e pese mijë) lekë
- 3- Marianthi Qirici të ndimohet përkatësisht në shumën 20.000 (njezete mijë) lekë.
- 4- Flutura Beqo të ndimohet përkatësisht në shumën 20.000 (njëzetë mijë) lekë.
- 5- Mina Ballabani të ndimohet përkatësisht në shumën 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë.
- 6- Fariol Vasil Metko, frekuenton linjen Bodar-Permet-Bodar i cili do perfitoje 12000 (dymbedhjete mije) lekë per periudhen Janar-Maj,viti shkollor 2024-2025

Bashkengjitur i gjithë dokumentacioni përkatës.

Drejtori Shërbimit Social

Arjana PAPAPANO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____, 2025

**PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË NGASTRAVE PYJORE DHE KULLUSORE TË GATSHME
PËR TU DHËNË NË PËRDORIM PËR KULLOTË PËR 2025-2026**

Kryetari i Bashkisë, pasi shqyrtoi relacionin “Për miratimin e listës së ngastrave pyjore dhe kullusore të gatshme për tu dhënë në përdorim për kullotë për vitet 2025-2026” të paraqitur nga Sektori i Pyejeve dhe Kullotave, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligji nr.8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, Ligji nr.8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Ligji nr.9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar, VKM nr.433 date 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyejeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive” i ndryshuar me VKM 398 datë 13.05.2020, Udhëzimi nr.2 datë 20.7.2016 i Ministrisë së Mjedisit “Për kriteret teknike dhe procedurat për dhënien e ngastrave pyjore dhe kullusore në përdorim”. Me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ngastrave pyjore dhe kullusore të gatshme për tu dhënë në përdorim për kullotë, për vitet 2025-2026 sipas listës bashkëlidhur.
2. Dhënia në përdorim e pasurisë të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi të kryhet sipas rregullave dhe procedurave të shpalljes të përcaktuara në Udhëzimin nr.2 datë 20.7.2016 i Ministrisë së Mjedisit dhe ligjin “Për fondin kullor”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Pyejeve Kullotave.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

**KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA**

Alma Hoxha





RELACION

Mbeshtetur Udhezimit te Ministrise se Mjedisit Nr.2 dt.20.07.2016 per kriteret Teknike dhe procedurat per dhenien e ngastrave pyjore dhe kullosore ne perdorim "Struktura Pergjegjese per pyjet e kullotat ne Bashki ben planifikimin e siperfaqeve pyjore dhe kullosore qe do te jepen ne perdorim dhe brenda muajit Shkurt ben miratimin e tyre nga Keshilli Bashkiak.

Nga studimi i kryer mendojme te japim ne perdorim per vitin 25-26 nje siperfaqe totale prej 8127.86 ha nga kjo siperfaqe e dobishme prej 6213.56 ha me nje kapacitet kullosor prej 21891 krere dhen ,8943 krere dhi 667 krere te trasha.

Keto te dhena jane planifikuar per kushtet optimale ku perfshihet infrastruktura perkatese si lera korrita,kryerje permiresimi,pastrim kullote etj..

Prandaj kerkojme miratimin e ketyre siperfaqeve per dhenie ne perdorim si kullota gje e cila do te gjeneroje te ardhura per Bashjkine Permet. .

Bashkangjitur po ju dergojme dhe evidencen e ngastrave qe do te jepen ne perdorim ne te jane dhe te dhenat perkatese si siperfaqe totale, siperfaqe e dobishme , kapaciteti kullosor si dhe lloji i kullotes (verore ose dimerore)

SPECIALISTI

Ing.Bledar TESHU

PERGJ.SEK. PYJE-KULLOTA

Ing.Thanas NIKOLLA



Evidenca e ngastrave kullimore qe planifikohen te jepen me qira per vi per vitin 2025-2026

Ekonomia kullimore	Nr. Ngastrave	Sip. Totale ha	Sip e dobishme ha	Kapaciteti mbajtes i krereve										
				kullote verore			kullote dimeroze							
				dhen kerë	dhi krere	te trasha krere	afati i perdorimit	dhen krere	dhi krere	te trasha	afati perdorimit	shenime		
				01.06.2025				01.11.2025						
										31.10.2025				
Nemercke(Kullote)	1	109	100						475	200	S'ka	Po		
" " "	2	103	96.82						280	185		5	Po	
" " "	3	39	35.95						258	130	S'ka		Po	
" " "	4	15.83	13.76						248	170				
" " "	5	69.12	64.83						160	150		50		
" " "	6	155.22	147.37						150	250		60		
" " "	7	32	29.83						155	8		58	Po	
" " "	8	33.57	27.98						590	60		150	Po	
" " "	9	146.8	122.88						685	25		170	Po	
" " "	10	68.34	64.46						210	50	S'ka		Po	
" " "	11	88	80.1						218	50	S'ka		Po	
" " "	12	76.48	73.48		65	ska	ska							
" " "	13	47.69	41.99		160	ska	ska							
" " "	20	25.58	16.89		250	S'ka	S'ka	Po						
" " "	21	214.23	68.23		243	S'ka	S'ka	Po						
" " "	22	174.92	170.42		530	S'ka	S'ka	Po						
" " "	23	84.59	57.61		400		90	S'ka	Po					
" " "	24	160.37	106.92		400	S'ka			14	Po				
" " "	25	216.12	102.12		400		80	S'ka	Po					
" " "	26	114.89	52.58		350	S'ka	S'ka	Po						
" " "	27	88.09	38.05		600	S'ka	S'ka	Po						
" " "	28	166.66	78.41		600	S'ka	S'ka	Po						
" " "	29	186.13	106.25		700	S'ka	S'ka	Po						
" " "	30	166.9	72.04		208	S'ka	S'ka	Po						
" " "	31	167.37	88.18		390	S'ka	S'ka	Po						
" " "	32	165.75	84.81		304	S'ka	S'ka	Po						
" " "	33	195.84	82.59		331	S'ka	S'ka	Po						
" " "	34	187.34	118.74		432	S'ka	S'ka	Po						
" " "	35	236.42	131.98		530	S'ka	S'ka	Po						
" " "	39	105.51	50.56		316	S'ka	S'ka	Po						
" " "	40	74.12	37.5		284	S'ka	S'ka	Po						
Dhëmbel (Kullote)	1	68.62	46.63		350	S'ka			5	Po				
" " "	2	52.8	39.12		550	S'ka			10	Po				
" " "	3	78.65	57.4		300		100		5	Po				
" " "	4	86.12	47.01		650	S'ka			10	Po				
" " "	5	96.63	88.41		650	S'ka			10	Po				
" " "	6	86	56.01		250		500		40	Po				
" " "	7	96.67	80.22		730				10	Po				
" " "	8	40.96	21.75		700									
" " "	9	142.31	98.04		700	S'ka	S'ka	Po						
" " "	10	39.79	29.79						100	80		15		
" " "	11	152.63	105.33		700	S'ka	S'ka	Po						
" " "	12	136.76	95.39		700	S'ka	S'ka	Po						
" " "	13	146.47	95.39		650	S'ka			10	Po				
" " "	14	124.11	85.2		650	S'ka			5	Po				
" " "	15	80.19	52.37		650	S'ka			5	Po				
" " "	16	2.47	2.17				80		5					
" " "	17	169.35	147.02		690		150	S'ka	Po					
" " "	18	42.32	34.58		420		50							
" " "	19	141.16	107.64		546		150	S'ka	Po					
" " "	20	25.35	22.11		80									
Frash-Koblare(Kullot)	19	143.85	102.14		320		100							
Qilarisht-Raban(Kullot)	1	66	47		220		30							
" " "	2	46	30		163		110							
" " "	4	61	37		70		116							
Ek.Pyjore Dh-Kala	70a	17.14	17.14				35							



"	"	"	70b	8.03	8		16						
"	"	"	70b1	10.45	10.45		20						
"	"	"	73a	15.23	15.23		30						
"	"	"	73b	26.28	26.28		78						
"	"	"	74a	29.21	29.21		60						
"	"	"	74b	7.83	7.83		24						
"	"	"	75a	12.24	12.24		36						
"	"	"	75b	29.09	29.09		58						
"	"	"	76a	24.64	24.64		75						
"	"	"	76b	12.03	12.03		24						
"	"	"	77	30.48	30.48		60						
"	"	"	78	37.07	37.07		110						
"	"	"	66a	26.36	26.36		75						
"	"	"	86	39.35	39.35		126						
"	"	"	87	54.73	54.73		160						
"	"	"	88a	17.11	17.11		34						
"	"	"	93a	42.41	42.41		126						
"	"	"	96a	16.02	16.02		48						
"	"	"	96b	1.53	1.53		5						
"	"	"	98a	21.51	21.51		40						
"	"	"	98b	15.19	15.19		30						
"	"	"	99a	40.36	40.36		80						
"	"	"	109	40.27	40.27		40						
Ek.Pyjor.Lomnice			177	43.04	43.04	S'ka	86	S'ka	Po				
"	"	"	178a	30.11	30.11	S'ka	90	S'ka	Po				
"	"	"	179	23.78	23.78	S'ka	70	S'ka	Po				
"	"	"	180a	47.41	47.41	S'ka	140	S'ka	Po				
"	"	"	182a	26.12	26.12		78				40		
"	"	"	183a	38.98	38.98		114				90		
"	"	"	184	36.06	36.06		108				70		
"	"	"	185a	30.9	30.9		90				60		
Ek.Kullos P-Zavalan			17	104	100	130	25	30					
Ek.Pyj.Petr-Çarshove			183	6.52	6.52					S'ka	13	S'ka	
"	"	"	184	8.56	8.56					S'ka	17	S'ka	
"	"	"	186a	29.31	29.31					S'ka	60	S'ka	
"	"	"	191a	21.72	21.72					S'ka	42	S'ka	
"	"	"	226	8.23	8.23		24						
"	"	"	227	17.75	17.75		51						
"	"	"	228	4.46	4.46		12						
"	"	"	236	14.05	14.05		42						
"	"	"	237	29.96	29.96		90						
"	"	"	238a	42.39	42.39		120						
Ek.Pyjore Nemërçkë			38a	58.44	58.44		116						
"	"	"	39a	69.04	69.04		138						
"	"	"	42	57.12	57.12		110						
"	"	"	43a	36.08	36.08		74						
"	"	"	43c	7.39	7.39		20						
"	"	"	86a	41.2	41.2		80				80	ska	
"	"	"	86b	11.69	11.69		33				33	ska	
"	"	"	87a	29.95	29.95		58				58	ska	
"	"	"	87b1	2.27	2.27		5				5	ska	
"	"	"	87b2	1.04	1.04		3				3	ska	
"	"	"	87b3	1.02	1.02		3				3	ska	
"	"	"	88a	40.23	80		80				80	ska	
"	"	"	89a	36.52	36.52		72				72	ska	
"	"	"	90a	26.1	26.1		52				52	ska	
"	"	"	91	45.76	45.76		92				92	ska	
"	"	"	92a	33.11	33.11		33				33	ska	
"	"	"	92b	11.72	11.72		22				22	ska	
"	"	"	94	39.83	39.83		78				78	ska	
"	"	"	96	46.03	46.03		92				92	ska	
"	"	"	98a	32.51	32.51		64				64	ska	
"	"	"	99	0.57	0.57		1				1	ska	
"	"	"	99d	0.97	0.97		2				2	ska	
"	"	"	99d1	0.67	0.67		1				1	ska	
"	"	"	99c/1	5.53	5.53		10				10	ska	



"	"	"	105a	21	21		63			63	ska								
"	"	"	105b2	4.14	4.14		15			15	ska								
"	"	"	105b3	1.39	1.39		5			5	ska								
"	"	"	105b4	11.47	11.47		33			33	ska								
"	"	"	105b5	1.3	1.3		3			3	ska								
"	"	"	55	37.16	37.16		74												
"	"	"	137a	18	18	S'ka	36	S'ka											
"	"	"	138a	21.86	21.86	S'ka	43	S'ka											
"	"	"	138a1	3.83	3.83	S'ka	7	S'ka											
"	"	"	138c	8.56	8.56	S'ka	17	S'ka											
"	"	"	139	44.29	44.29	S'ka	88	S'ka											
"	"	"	140a2	14.96	14.96	S'ka	30	S'ka											
"	"	"	140a2	19.41	19.41	S'ka	39	S'ka											
"	"	"	146a	12.37	12.37	S'ka	25	S'ka											
"	"	"	146b	24.68	24.68	S'ka	50	S'ka											
"	"	"	147a	13.83	13.83	S'ka	27	S'ka											
"	"	"	147b1	28.91	28.91	S'ka	57	S'ka											
"	"	"	148	26.42	26.42	S'ka	52	S'ka											
"	"	"	148c	4.32	4.32	S'ka	8	S'ka											
"	"	"	149	25.85	25.85	S'ka	51	S'ka											
Ek.pyjore P-Zavalan			1a	0.64	0.64		3												
"	"	"	1d	22.83	22.83		45												
"	"	"	2a	23	23		46												
"	"	"	3a	29	29		58												
"	"	"	204a1	38.32	38.32		38												
"	"	"	204b	17.57	17.57		17												
"	"	"	205a	38.96	38.96		38												
TOTALI				8127.86	6213.56		18362	6293	159		3529	2650	508						

Specialisti
Ing. Breda TESHU

Pergjegjesi i Sherbimit per pyjet dhe Kullotat
Ing. Thanas NIKOLLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P./V E N D I M

NR. _____ DATË _____ .2025

Për miratimin e rinovimit të kontratës së qirasë Nr.1642 Prot ,datë 04.07.2018 e emërtuar si “Site 1216 Petran”për dhënien me qira të sipërfaqes 20 m² të pasurisë me nr. 395, zona kadastrale nr.3967 Ekonomia Pyjore Petran ku është vendosur antenë fikse e telefonisë celulare Vodafone Albania.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin 121/2013 datë 18.4.2013, Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 54 pika e), neni 19 ,i Ligjit Nr.9385 ,datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”i ndryshuar me Ligjin 48/2016 datë 05.05.2016, VKM Nr.806 datë 06.10.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike,shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Petran të Qarkut Gjirokastrër” VKM Nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish komunave/bashkive”, VKM 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” , i ndryshuar me VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” ndryshuar me vendim nr. 267 datë 27.4.2023“Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”,shkresa nr.21/ht prot,date 16.04.2024,“Kërkesë për rinovim të kontratës së qirasë nr.1642,date 04.07.2018”, Kryetari i Bashkisë pasi shyrtoi relacionin “Për miratimin në parim të procedurave të rinovimit të kontratës për dhënien me qera të sipërfaqes 20 m² me nr.pasurie 395 Ekonomia pyjore Petran ku është vendosur antenë fikse e telefonisë celulare Vodafone Albania,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien në përdorim, të sipërfaqes prej 20 m² të ndodhur në Zonën Kadastrale 3967, NB Përmet I, me Nr.Pasurie 395, për vendosje antene fikse të telefonisë celulare Vodafone, sipas planvendosjes bashkëlidhur.
2. Vlera vjetore e qerasë së kontratës do të jetë 168,750 (Njëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë e përlllogaritur në bazë të VKM nr.559, datë 29.07.2022 ndryshuar me vendim nr. 267 datë 27.4.2023“Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” .

3. Dhënia në përdorim e kësaj sipërfaqe do të bëhet për një afat 6 (gjashtë) vjeçar, afat i cili fillon nga data e përfundimit të afatit të kontratës së mëparshme, me të drejtë ripërsëritje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Finance Buxhet, Burimeve Njerezore dhe shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, bujqësisë dhe Turizmit, Drejtoria e Urbanistikës Planifikimit të Territorit/ Sektori Juridik dhe i Prokurimeve.
5. Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Permet më, ___ / ___ / 2025

RELACION

Për miratimin e rinovimit të kontratës së qirasë Nr.1642 Prot ,datë 04.07.2018 e emërtuar si “Site 1216 Petran”për dhënie me qira të sipërfaqes 20 m²,të pasurisë me nr. 395 zona kadastrale nr.3967 Ekonomia Pyjore Petran ku është vendosur antenë fikse e telefonisë celulare Vodafone Albania.

Subjekti i telefonisë celulare Vodafone Albania ka nënshkruar një kontratë qiraje me Komunën Petran sot Njësia Administrative Petran për marrjen me qira të sipërfaqes pyjore 20 m² të ndodhur në Komunën Petran sipas kontratës me nr.1642,datë 04.07.2018, me qëllim vendosjen e një antene të telefonisë celulare.

Kontrata është nënshkruar për një afat 6 vjeçar duke filluar nga data 04.07.2018 deri më datë 16.04.2024 referuar bazës ligjore në fuqi VKM Nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” i ndryshuar me VKM Nr. 1064, datë 22.12.2010, me vlerë vjetore të qirasë 168 750 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë,përfshirë këtu taksat dhe tatimet që aplikohen lidhur me qeranë dhe pasurinë e paluajtshme.

Pas ndarjes së re administrativo-territoriale, ku funksionet e Komunave i kaluan Bashkisë Permet, u bë edhe amendimi i kësaj kontrate për zëvendësimin e palës kontraktuese nga Komuna Petran në Bashkia Permet pa u ndryshuar asnjë nga elementet e tjerë të kontratës.

Me shkresën Nr.21 Prot,datë 16.04.2024 është kërkuar nga kompania rinovimi i kontratës së qerasë në përfundim të afatit të përcaktuar në kontratën e nënshkruar në datë 04.07.2018.

Përpara miratimit të kërkeses është bërë verifikimi i dokumentacionit të kompanisë, verifikimi i statusit të pronësisë të pasurisë ku janë vendosur antenat, i sipërfaqes që aktualisht zë antena e Vodafone Albania dhe i vlerës së qirasë.

1. Nga verifikimi i kryer nga rezulton se pasuria ku është vendosur antena e Vodafone Albania është pjesë e fondit pyjor Petran e pasurisë me nr.395 e ndodhur në zonën kadastrale me nr.3967 ,transferuar në pronësi të Bashkisë Permet me VKM Nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”.
2. Vlera e qirase për këtë sipërfaqe e përllogaritur sipas tarifave të ndryshuara me VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” ndryshuar me vendim nr. 267 datë 27.4.2023“Për

pyjeve dhe të kullotave” ndryshuar me vendim nr. 267 datë 27.4.2023“Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” do të jetë 168,750 (Njëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë ,vlerë kjo e dakortësuar në kontratën me nr.1642,date 04.07.2018 dhe parashtuar per rinovim me të njëjten vlerë dhe të njëjtat kusht si kontrata e pare,në shkresën nr.21,date 16.04.2024,”kërkesë për rinovim kontrate”.

Sa më sipër kërkohet dhenia me qira e sipërfaqes 20m² dhe miratimi i rinovimit të kontratës së qirasë për parcelën me nr. 395 zona, kadastrale nr.3967, ku është vendosur antenë fikse e telefonisë celulare Vodafone Albania .

Konceptoi :

SP. Zyres Juridike Ketrina Lile

Përgj.i Sektorit të Taksave dhe Aseteve Dorjan Metko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. _____ dt _____ / _____ /2025

PËR

NJË NDRYSHIM NË VKB NR 114 DT 18.12.2024 "PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MESATARE TË APARTAMENTEVE NË TREGUN E LIRË PER VITIN 2025 NË BASHKINË PËRMET.

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën _____ / _____ /2025, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvecionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", pika 2/b dhe pika 10, Vendim Nr.301, Datë 15.4.2020 "Për Normat e Strehimit si dhe Kushtet e Standardet për banesat Sociale me Qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", Vendim Nr. 384, Datë 12.6.2019 "Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar Strehim sipas çdo programi Social të Strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore" VKB nr 114 datë.18.12.2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga komisioni konsultativ i strehimit për ndryshimin e masës së qirasë në tregun e lirë në qytetin e Përmetit dhe me propozim të Kryetari të Bashkisë.

VENDOSI:

- 1- Te miratojë ndryshimin e pikës 1 të VKB Përmet nr. 114 date 18.12.2024 si më poshtë:
Masa e qirasë mesatare të apartamenteve në tregun e lire për vitin 2025 në Bashkinë Përmet të jetë:

Për apartamente të tipit Garzionere : 6 000 lek.

Për apartamente të tipit 1+1 : 7 000 lek.

Për apartamente të tipit 2+1 : 9 000 lek.

- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit, Drejtoria e Financë-Buxhetit-Taksa Tregje,Zyra e Aseteve dhe Shërbimeve Publike në Bashki.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË
ALMA HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

KOMISIONI KONSULTATIV I STREHIMIT

RELACION

PËR

**MBI NJË NDRYSHIM NË VKB NR 114 DT 18.12.2024 "PËR MIRATIMIN E MASËS
SË QIRASË MESATARE TË APARTAMENTEVEË NE TREGUN E LIRE PER VITN
2025 NE BASHKINË PËRMET**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Permet

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social", VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvecionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", pika 2/b dhe pika 10, Referuar këkesave të shumta të qytetarëve për bonusin e qirasë edhe sipas dokumentacionit rezultojnë familje në nevojë si dhe me probleme familjare të cilat mund të përfitojnë nga këto banesa. Me qëllim llogaritjen e qerases sociale për familjet që plotesojnë kriteret është e nevojshme miratimi i masës së qerases për Bashkinë Permet në varësi të llojit të apartamentit të qerases sociale në treg.

a) Të përgjithëshme:

Një nga format e trajtimit me strehim të familjeve në nevojë është dhënia e subvencionit të qirasë në tregun e lirë, i cili ka nisur si iniciativë në Bashkinë e Permetit në vitin 2020 me 8 familje dhe në vitin 2023 në përfitueseve të bonusit të qirase arriti në 30 familje.

Bashkia e Permetit ka vijuar me ofrimin e përfitimit të bonusit të strehimit, ku sipas së cilit subvencionohet një pjesë e konsiderueshme e qirasë së banesës, për familjet të cilat jetojnë me qira dhe kanë të ardhura të pamjaftueshme për ta përballuar atë.

Programi i banesave sociale me qira është programi, me anë të të cilit jepen me qira banesat në pronësi publike nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë në pronësi të pronarit social.

Banesat sociale me qira përfshijnë:

a) banesat sociale që ndërtohen ose blihen nga tregu i lirë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim që të jepen me kontratë qiraje sociale;

b) banesat ekzistuese në treg, në pronësi të pronarit social.

REPUBLIC OF SOUTH AFRICA
SET BASH



Aktualisht ne Bashkine Permet trajtohen me qera sociale 30 familje. Referuar kerkesave te depozituara ne Bashki per perfitimin nga programet sociale te strehimit ky numer eshte variabel ne varesi te kushteve te perfitueseve per vitin ne vazhdim.

b) Kufijtë e të ardhurave të individëve/familjeve që përfitojnë nga banesat sociale me qira?

1. Nga fondi i banesave sociale me qira, jo më pak se 80 për qind e familjeve që përzgjidhen të trajtohen në banesa sociale me qira duhet të kenë të ardhura nga 0 deri 100 për qind të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.
2. Pjesa tjetër, jo më shumë se 20 për qind e familjeve mund të përzgjidhet brenda intervalit 100–120 për qind të nivelit të të ardhurave mesatare.

c) Përcaktimi i qirasë

1. Kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose buxheti i njësisë të vetëqeverisjes vendore, ose kombinimi i të dyjave, masa e qirasë, e shprehur në lekë/m² sipërfaqe ndërtimi llogaritet nga struktura përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore, brenda kufirit të përcaktuar në pikën 2 më poshtë.
2. Masa e qirasë miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas metodikës për llogaritjen, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Masa e qirasë vjetore nuk duhet të jetë më e madhe se 3 për qind e kostos së ndërtimit të banesës nga institucionet shtetërore, për banesat e reja, ose 3 për qind e vlerës së banesës së blerë në treg, përveç rastit të përcaktuar në pikën 5 më poshtë.
4. Për objektet e dala jashtë funksionimit dhe ato të kthyer në fond banesash sociale me qira, masa e qirasë përcaktohet nga këshillat e njësisë të vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 2, më sipër, bazuar në vlerën kapitale të transferuar dhe kostot e ndërhyrjes për përshtatjen e tyre.
5. Kur banesat sociale me qira financohen nga fondet e investimeve të buxhetit të shtetit kur njësia e vetëqeverisjes vendore ka ngritur strukturën përgjegjëse për menaxhimin e strehimit ose ka përcaktuar përgjegjësitë në një nga strukturat ose ka hartuar programin 5-vjeçar të strehimit, masa e qirasë përcaktohet nga subjektet që e kanë financuar dhe njësia e vetëqeverisjes vendore dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku zbatohet projekti.
6. Masa e qirasë, e shprehur në lekë për metër katror, duhet të mbulojë kostot për administrim, mirëmbajtje, kosto operacionale dhe kosto të investimit ose të shlyerjes së borxhit. Niveli i qirasë sociale nuk duhet të jetë më i lartë se niveli mesatar i qirasë në tregun e lirë.

d) Rregullat e përgjithshme mbi subvencionimin e qirasë.

1. Subvencionimi i qirasë si rregull kryhet nga të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Subvencionimi i qirasë mund të bëhet edhe nga pushteti qendror, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 35, të këtij ligji.
2. Aplikimi i individit/familjes për të përfituar nga subvencionimi i qirasë do të bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e përfituesve për subvencionimin e qirasë miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndërtohet banesa. Kur subvencionimi i qirasë financohet pjesërisht ose plotësisht nga qeverisja qendrore, lista e përfituesve, e miratuar nga bashkia, i përcillet ministrisë përgjegjëse për strehimin, e shoqëruar me kërkesën për financim.



3. Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë, por pa u kufizuar në to, kategoritë e mëposhtme: a) individët me statusin e jetimit; b) personat me aftësi të kufizuara; c) të moshuarit; ç) invalidët e punës; d) familjet e policëve të rënë në detyrë; dh) emigrantët e rikthyer; e) punëtori emigrant; ë) azilkërkuessit; f) familjet e komunitetit rom; g) familjet e komunitetit egjiptian; gj) Viktimat e dhunës në familje; h) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit; i) prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë; j) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individit nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji; k) të miturit, 14–18 vjeç, dhe të rinjtë, 18–21 vjeç, në konflikt me ligjin, kur dalin në lirim pas kryerjes së dënimit, kur kanë nevojë për banesë, sepse duhet të jetojnë larg familjeve, për shkak të rehabilitimit të tyre më të mirë në shoqëri; l) vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara; ll) familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012. Radhën e përparësisë së kategorive e përcakton këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore me vendim.

e) Subvencionimi i qirasë për banesat në pronësi të pronarit social

1. Subvencionimi i qirasë për banesat bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, **me miratimin e këshillave të njësisë së vetëqeverisjes vendore** të veta, kur nuk kanë fond të lirë banesash sociale me qira, si rregull kur: a) nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg; b) ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm sesa subvencionimi i qirave; c) familja është në kushtet e emergjencës për strehim dhe kur nuk përfiton nga një program tjetër.

2. Bëjnë përjashtim nga kushtet e parashikuara në pikën 1, më sipër, rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatojnë se: a) familja që kërkon të strehohet në banesa sociale me qira banon në një banesë me qira, e cila ndodhet pranë vendit të punës, shkollës së fëmijëve, qendrave shëndetësore ose pranë shërbimeve të tjera; b) banesa sociale me qira është siguruar me financim nga persona juridikë privatë dhe qiraja është sipas pikës 5, të nenit 30, të ligjit nr.22/2018.

ë) Administrimi i subvencionit të qirasë në pronësi të pronarit social

1. Subvencioni paguhet drejtpërdrejt në llogari të pronarit, ndërsa qiramarrësi përfiton vetëm të drejtën për të përdorur banesën me qira. Subvencioni i qirasë jepet **me miratimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore**, në përputhje me buxhetin që jepet çdo vit për subvencionimin e qirave, sipas nenit 33, të ligjit nr.22/2018, dhe bazuar në kriteret që duhet të plotësojë familja për të përfituar subvencionimin e qirasë sipas këtij ligji.

2. Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategori të përcaktuara në pikën 3, të nenit 34, të këtij ligji, nëpërmjet buxhetit të shtetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përcaktimi i vlerës së subvencionit të qirasë në tregun e lirë

1. Vlera e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100 për qind e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku jepet ky subvencion. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet çdo vit, bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm,



dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Pagesa që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionimit të qirasë nuk duhet t'i kalojë 25 për qind të të ardhurave të familjes.

3. Mënyra e llogaritjes së vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

f) Banesat ne treg me Qira

Kriteret e përzgjedhjes se përfituesve:

Trajtohen me përparësi individët ose familjet qe plotësojnë kushtet e nenit 4 pika 1 dhe qe kane këto specifika:

- a) familjet, te cilat vërtetojnë se nuk kane përfituar nga ligji nr.7652, date 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore";
- b) familjet, ku kryefamiljari është grua e ve ose e divorcuar;
- c) familjet njeprinderore, qe kane ne ngarkim fëmijë;
- ç) te moshuar qe kane mbushur moshën e pensionit dhe qe nuk përzgjidhen për t'u strehuar ne institucionet publike te perkujdesit shoqëror;
- d) individët me aftësi te kufizuar, te cilët gëzojnë statusin e te verbrit te grupit te pare, te invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, te invalidit te punës dhe te invalidit te Luftës Nacionalçlirimtare;
- dh) familjet me shume fëmijë;
- e) çiftet e reja me moshe totale deri ne 55 vjeç;
- ë) familjet qe kane ndryshuar vendbanimin për efekt punësimi;
- f) individët me statusin e jetimit qe nga çasti i daljes nga jetimoret ose nga qendrat e perkujdesit e deri ne moshën 30 vjeç.
- i) Familjet e komunitetit rom dhe egjyptian.

Ata do të zgjidhen sipas sistemit te pikëzimit, sipas kushteve të mësipërme, bazuar edhe në numrin e anëtarëve të familjes e të ardhurave që marrin. Janë 4 kushte bazike? familjare, sociale, ekonomike, e banimi ato që bëjnë të mundur llogaritjen e pikëve, njëkohësisht edhe seleksionimin. Konkretisht, lidhur me kushtet familjare, trajtohen me përparësi familjet një prindërore, që kanë në ngarkim fëmijë? të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore? familjet me më shumë se katër fëmijë? si dhe çiftet e reja me moshë totale deri në 60 vjeç, familjet e komunitetit egjyptian.

Ndërsa, sa i përket kushteve sociale, me përparësi do trajtohen personat me aftësi të kufizuara, personat me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç? emigrantët e rikthyer? familjet e policëve të rënë në detyrë? viktimat e dhunës në familje? viktimat e trafikimit? komuniteti Rom? komuniteti Egjyptian, të miturit në konflikt me ligjin, pas ekzekutimit të dënimit? dhe të rejat nëna, që bëhen nëna të vetme.


Përfundime:

Duke patur parasysh rritjen e qirave aktualisht në tregun e lire ne Qytetin e Permetit propozojme qe masa e qirase e propozuar dhe e miratuar ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise ne dt.18.12.2024, te ndryshoje si poshte:


Për apartamente të tipit Garzionere :	nga 4 000 lek te behet	6 000 lek.
Për apartamente të tipit 1+1 :	nga 5 000 lek te behet	7 000 lek.
Për apartamente të tipit 2+1 :	nga 7 000 lek te behet	9 000 lek.


Duke ju falenderuar


Komisioni Konsultativ i strehimit:

Kryetar Aulona Meshini 

Anëtar Anton Imeraj 

“ “ Arjana Papapano 

“ “ Jurgen Simoni 

“ “ Pavlina Hormoviti 





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. ____ dt. ____ / ____ /2025

PËR
PËR VENDOSJEN E NJË PLLAKADE NË RRUGËN “At Stath Melani” NË LAGJEN
HISTORIKE QYTETI PËRMET

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 8, nenin 9.1, pika 1.1/a dhe “b”, pika 1.7/b, nenit 54, pika 2, në kërkesën e paraqitur nga trashëgimtari i familjes “Faniko” z. Sotir Faniko, të miratuar nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë si dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban dhe zyra e Shërbimeve Publike, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I :

- 1- Të miratojë vendosjen e një pllakade në rrugën “At Stath Melani” në Lagjen Historike të Qytetit Përmet (tek çesma e vjetër (*ekzistuese*) e “Fanikove” me dimensione 60 x 40 cm, me mbishkrimin “ÇESMA E FANIKOVE”
- 2- Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, Sektori i Shërbimeve Publike.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI I BASHKISË
ALMA HOXHA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

*DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT URBAN
SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE*

RELACION

**MBI PROJEKT-VENDIMIN PËR VENDOSJEN E NJË PLLAKADE NË RRUGËN “At Stath Melani”
NË LAGJEN HISTORIKE, QYTETI PËRMET**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Përmet.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 8, nenin 9.1, pika 1.1/a dhe “b”, pika 1.7/b, nenit 54, pika 2, në kërkesën e paraqitur nga trashëgimtari i familjes “Faniko” z. Sotir Faniko, hartohet ky relacion si më poshtë:

A. Mbi historikun e familjes “Faniko”

Familja “Faniko” është një nga familjet më të vjetra të Përmetit në lagjen e vjetër historike. Nga të parët e kësaj familje (*periudha nuk dihet*) është ndërtuar një cesëm mbështetur në murin e banesës së tyre, e cila u shërbente jo vetëm banorëve të lagjes, por edhe kalimtarëve të rrugës At Stath Melani. Kjo cesëm ekziston ende, ashtu sic ka qënë vite më parë, pamvarësisht se nuk është funksionale, dhe nga banorët e vjetër njihet si cesma e “Fanikove” Paraardhësit e kësaj familje kanë migruar brënda apo jashtë vendit

Një nga pasardhësit e kësaj familje është mësuesi i njohur **Harito Faniko** i cili ka qënë Drejtori i parë Shkollës së Mesme, dhe pas shërbeu si mësues kimie në këtë shkollë. Nga trashëgimtarët e kësaj familje e cila vazhdon të jetojë ende në këtë shtëpi është Parashqevia e cila është në moshë të madhe dhe me shëndet jo të mirë.

B- Vendosi e pllakadës.

Në kërkesën e trashëgimtarit të familjes “Faniko” drejtuar Bashkisë Përmet, dhe Këshillit të Bashkisë, shpreh dëshirën për vendosjen e një pllakade me dimensione 60x40 cm me mbishkrimin “Çesma e Fanikove”. Këtë dëshirë e kanë shprehur edhe fëmijët e tij të cilët jetojnë në Amerike dhe Francë të cilët shumë të lidhur më origjinën e tyre, Qytetin e Përmetit, dhe e vizitojnë qytetin pothuajse cdo vit. Shpenzimet për vendosjen e kësaj pllakade i mer përsipër vetë kërkuesi z.Sotir Faniko.

Pozicioni i çesmës është në rrugën “At Stath Melani” në koordinatat: 40°13'53.57"N 20°21'3.74"E
Dimensionet e pllakadës do të jenë 60 x 40 cm.



C- Propozimi për miratim.

Miratimi i këtij vendimi do të shërbejë së *pari* jo vetëm si respekt për të intersuarit (pasardhësit e familjs “Faniko”, por njëkohësisht edhe si një model vlerësimi për banorët me origjinë nga Përmeti, pamvarësisht së ku punojnë e jetojnë, brënda apo jashtë Shqipërisë, janë shumë të lidhur më prejardhjen e tyre. Së *dyti* Lagja Historike e qytetit është kthyer tashmë në një zonë tejet të frekuentuar nga vizitorët sidomos turistët e huaj dhe kjo çesëm është pjesë e historisë së kësaj lagje dhe vendosja e pllakadës do ti shërbejë sado pak promovimit të kësaj historie.

Duke ju falenderuar

Hartuesit e Relacionit:

Drejtori Planifikimit dhe Zhvillimit Urban
Ing. Laert BUSHI



Specialisti i Shërbimeve Publike
Arian Jaupi



KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 22.12.2024

Lënda : Kërkesë

Drejtuar: BASHKISË PËRMET

Dërguesi: Sotir Faniko

Rruga Mihal Grameno, Pallati 95, shkalla nr. 2, Ap nr.7. Tiranë. Nr. Tel 0682660485.

Unë që po ju drejtoj këtë kërkesë quhem Sotir Qako Faniko, lindur në qytetin e Përmetit në vitin 1947, aktualisht banues në Tiranë. Përpara 150 (njëqind e pesëdhjetë) vitesh përpara derës së shtëpisë në të cilën kam jetuar në Përmet, ka ekzistuar një çezmë e cila nga përmetarët quhej "Çezma e Fanikove". Këtë vit, mbesa ime sëbashku me familjen e saj të cilët jetojnë në Amerikë si dhe vajza ime me familjen e saj të cilët jetojnë në Francë vizituan shtëpinë në të cilën kemi jetuar në Përmet dhe vunë re se vendi i çezmës me një tub ekziston pranë derës ashtu si ka qenë vite më parë. Çezma ndodhet në adresën Rruga "At Stath Melani" në qytetin e Përmetit.

Në lidhje sa më lart shprehim dëshirën për të vendosur një pllakë graniti me përmasa 60 cm x 40 cm me mbishkrimin "Në kujtim të çezmës së familjes Faniko".

Shpenzimet do të mbulohen nga ana e familjes tonë.

Sa më sipër kërkojmë nga ana juaj miratimin e kësaj kërkesë.

Në pritje të një përgjigje nga ana juaj, ju uroj festa të gëzuara.

Me respekt Sotir Faniko.

Sotir Faniko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. ___ datë ___ / ___ 2025

PËR

PËR MIRATIMIN E MENUVE DHE KUOTËS USHQIMORE, PËR OFRIMIN E VAKTEVE USHQIMORE NË KUADËR TË PROJEKTIT «PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË»

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin Nr.115/2024“Për buxhetin e vitit 2025”, VKB Nr.107 datë 18.12.2024 “Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2025”; VKB Nr.79 datë 23.10.2024 “Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë», Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Miratimin e 7 (shtatë) menuve për vaktet ushqimore që do të ofrohen për individët përfitues.
2. Kuota për 1 (një) vakt ushqimor që do të ofrohet për përfituesit në kuadër të zbatimit të Projektit “Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë” të përcaktohet në vlerën 400 lekë me TVSH.
3. Shpenzimet për blerjen e ushqimeve të përballohen nga buxheti i projektit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik; Drejtoria e Buxhet-Financë; Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte dhe Drejtoria e Projekteve
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më 13.02.2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E MENUVE DHE KUOTËS USHQIMORE, PËR OFRIMIN E VAKTEVE USHQIMORE NË KUADËR TË PROJEKTIT «PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË»

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin Nr.115/2024“Për buxhetin e vitit 2025”, VKB Nr.107 datë 18.12.2024 “Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2025”; VKB Nr.79 datë 23.10.2024 “Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë»,

Grupi i synuar i projektit është mosha e tretë ose pensionistët të cilët jetojnë vetëm pa asnjë të afërm pranë, Personat me aftësi të kufizuara, Personat në situatë vulnerabiliteti të shumëfishtë, Persona pjesë e Komunitetit Egjyptian, Persona në vështirësi ekonomike etj. Përfitimet e grupit të synuar lidhen kryesisht me:

Përmirësimi i qasjes në shërbime sociale përmes rritjes së numrit dhe llojeve të shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë. (Qëllimi 2 në planin social). Për të kontribuar në arritjen e këtij qëllimi ky projekt ka dy objektiva specifike:

Objektivi 1: Të ngrihet dhe të vihet në funksion qendra ditore e të moshuarve duke ofruar shërbime për të moshuarit dhe grupet në nevojë. (Shërbimet do të ofrohen për të moshuarit e vetmuar, personat me aftësi të kufizuara, personat në situatë vulnerabiliteti të shumëfishtë.)

Objektivi 2.3 në Planin Social

Objektivi 2: Të rrisë përfshirjen sociale të moshës së tretë dhe grupeve në nevojë në qytetin e Përmetit nëpërmjet realizimit të aktiviteteve social-kulturore.

Me përcaktimin e listës së individëve përfitues, cdo procedurë që do të ndiqet për zbatimin e projektit është konform legjislacionit në fuqi. Bashkia Përmet ka nisur zbatimin e projektit duke përgatitur ambientin e dedikuar si Qendër ditore për të moshuarit që do të kalojnë kohën e lirë , njëkohësisht në këtë ambient do të ofrohet një vakt ushqimor për individët sipas kategorive në nevojë. Fillimisht do të nisë procedura për blerjen e ushqimeve. Për këtë, pas testimi të tregut dhe konsultimit me grupin e punës, kërkojmë miratimin e shtatë menuve javore(të cilat do të përsëriten cdo javë) me vlerë mesatare/vakt 400 lekë me TVSH/person , konkretisht e detajuar si mëposhtë:

Nr	Dita e javës	Vakti ushqimor sipas 7 menuve	gramatura
1	E hënë	Supë me mish vici, sallatë me perime, bukë , mollë	50 gr 67 gr 40 ml



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

		Gramatura për përbërësit (Mish, oriz, vaj, limon, kripë, kos, vezë, bukë, perime, qepë, vaj ulliri, kripë, mollë)	10 gr 33 gr 1/3 vezë 40 gr 100 gr 10 gr 10 ml 1.7 gr 180 gr
2	E martë	Fasule, sallatë jeshile, bukë, kek Gramatura për përbërësit (Fasule, sallatë, bukë, salcë e kuqe, kripë, vaj ulliri, vaj luledielli, qepë, karrota, qepë të njoma, kek)	67 gr 67 gr 40 gr 33 gr 10 gr 10ml 10 ml 40 gr 17 gr 40 gr 23 gr
3	E mërkurë	Mish me perime në furë, sallatë jeshile, djath, banane Gramatura për përbërësit (mish, specë, karrota, oriz, patate, qepë, kunguj, vaj, kripë, salcë domate, bukë, sallatë jeshilë, qepë të njoma, vaj ulliri, kripë, djath, banane)	100 gr 10 gr 40 gr 33 gr 67 gr 33 gr 10 gr 33 ml 3.3 gr 30 gr 40 gr 67 gr 10 gr 10 ml 30 gr 30 gr 200 gr
4	E enjte	Supë pule, byrek me lakra, sallatë me perime, bukë, portokall Gramatura për përbërësit (mish pule, miell, vezë, kos, kripe, limon,	50 gr 10 gr 1/3 vezë 20 ml



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

		miell, lakra, kripë, vaj ulliri, vaj luledielli, domate, qepë, sallator, bukë, portokall)	10 gr 33 gr 67 gr 67 gr 3 gr 10 ml 10 ml 67 gr 10 gr 50 gr 40 gr 200 gr
5	E premte	Turli me mish, pastico, sallatë me panxhar, mollë Gramatura për përbërësit (mish vici, specia, kunguj, patëllxhan, qepë, karrota, patate, vaj, kripë, bukë, makarona, qumësht, vaj luledielli, djath, vezë, panxhar, uthull, vaj ulliri, hudhër, mollë)	50 gr 10 gr 30 gr 33 gr 40 gr 40 gr 100 gr 40 ml 3 gr 40 gr 100 gr 67 ml 40 ml 40 gr 1/5 vezë 67 gr 6.7 ml 33 ml 1.7 gr 180 gr
6	E shtunë	Thjerrëza, pilaf, sallatë me perime, bukë, kek Gramatura për përbërësit (thjerrëza, vaj, kripë, uthull, salcë domate, hudhra, bukë, oriz, vaj luledielli, kripë, domate, qepë, sallator, vaj ulliri, kripe, kek)	33 gr 10 gr 3 gr 6.7 ml 33 gr 1.7 gr 40 gr 67 gr 40 ml 3.3 gr 67 gr



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

			33 gr 67 gr 33 ml 1.7 gr 23 gr
7	E diel	Patate në furë, fileto pule, sallatë jeshile, bukë , banane, pije freskuese Gramatura për përbërësit (patate, fileto pule, vaj luledielli, kripë, salcë domate, bukë, pije freskuese, sallatë jeshile, vaj ulliri, qepë të njoma, banane, pije freskuese)	200 gr 100 gr 40 ml 3.5 gr 33 gr 40 gr 330 ml 67 gr 10 ml 10 gr 200 gr 250 ml

Kuota për 1 (një) vakt ushqimor që do të ofrohet për individët në kuadër të zbatimit të Projektit “Përqafimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë” të përcaktohet në vlerën 400 lekë me TVSH/person.

Buxheti i projektit për zërin ushqime është:

3 432 000 lekë / 286 vakte /30 persona= 400 lekë me TVSH

Shpenzimet për mbulimin dhe blerjen e ushqimeve do të përballohen nga buxheti i projektit.

Kërkojmë nga Këshilli Bashkiak miratimin e menuve dhe kuotes për vakt ushqimor.

Faleminderit

Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte
Arjana Papapano

Drejtoria e Projekteve, Integritimit Evropian, Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave

Klaudja Ciko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. _____ datë _____ / _____ 2024

PËR

KALIMIN E LISTËS SË INDIVIDËVE PËRFITUES NË PROJEKTIN «PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË»»

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin Nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", VKB Nr. 107 datë 18.12.2024 "Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2025", VKB Nr. 79 datë 23.10.2024 "Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr. 72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë», Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e individëve përfitues në projektin "Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë", si mëposhtë:

Nr	Emer	Mbiemer	Pozicioni
1	Kujtim	Xhaferri	P.A.K, vështirësi ekonomike, i vetmuar
2	Veziro	Duralliu	Pensionist i vetmuar, Komuniteti Egjyptian, vështirësi ekonomike
3	Elsa	Xhoxhi	Pens.e vetmuar, vështirësi ekonomike
4	Jorgo	Xhavara	Pens.te vetmuar, vështirësi ekonomike
5	Eldi	Petro	P.A.K, i vetmuar, vështirësi ekonomike
6	Durim	Elmazi	PAK, i pastrehë
7	Dituri	Zeneli	P.A.K, Komuniteti Egjyptian, vështirësi ekonomike
8	Flutura	Zeneli	P.A.K, Komuniteti Egjyptian, vështirësi ekonomike
9	Zenel	Zeneli	P.A.K, Komuniteti Egjyptian, vështirësi ekonomike
10	Apostol	Dhiamanti	I vetmuar ne nevoje, i pastrehë
11	Filip	Tyto	I vetmuar, PAK, vështirësi ekonomike
12	Zoge	Naqe	Pensioniste vetmuar, vështirësi ekonomike
13	Marjeta	Çako	Invalide, vështirësi ekonomike
14	Kostandin	Papa	I vetmuar, vështirësi ekonomike, papërkrahje
15	Anxhelo	Zeqiri	I vetmuar, Komunitet Egjyptian, pa të ardhura
16	Spartak	Jemini	P.A.K, jetim, vështirësi ekonomike
17	Jorgo	Jemini	P.A.K, jetim, vështirësi ekonomike
18	Florand	Beqaraj	PAK, vështirësi ekonomike
19	Vali	Nika	Në gjendje të vështirë ekonomike

20	Liri	Çumani	Komuniteti Egjyptian, Ne gjendje te veshtirë ekonomike
21	Kastriot	Koto	I pastrehë, i vetmuar, ne gjendje te veshtire ekonomike
22	Anastas	Qorri	Pensionist i vetmuar
23	Evgjeni	Bushi	Pensioniste e vetmuar ne gjendje te veshtire ekonomike
24	Fatmira	Beqaraj	Familje ne kushte ekstreme te varfera
25	Lulezim	Beqaraj	Familje ne kushte ekstreme te varfera
26	Fatjon	Beqaraj	Familje ne kushte ekstreme te varfera
27	Shpresa	Jaupaj	Gjendje e veshtirë ekonomike, sëmundje shoqëruese
28	Koço	Tinko	Pensionist i vetmuar
29	Dashnor	Pelushaj	Familje ekstremisht e varfer
30	Gentian	Çaushaj	Familje me vështirësi ekonomike

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte dhe Drejtoria e Koordinimit të Integritimit Evropian/Projekteve të huaja/Marrëdhënieve me publikun dhe Median.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefektura.

KRYETAR I BASHKISË

ALMA HOXHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më 13.02.2025

RELACION

PËR

KALIMIN E LISTËS SË INDIVIDËVE PËRFITUES NË PROJEKTIN “PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË”

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin Nr.115/2024“Për buxhetin e vitit 2025”, VKB Nr.107 datë 18.12.2024 “Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2025”; VKB Nr.79 datë 23.10.2024 “Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përfaqimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë»,

Periudha e implementimit: Shkurt 2025- Dhjetor 2027

Grupi i synuar i projektit është moshë e tretë ose pensionistët të cilët jetojnë vetëm pa asnjë të afërm pranë Të moshuar që jetojnë vetëm, Personat me aftësi të kufizuara, Personat në situatë vulnerabiliteti të shumëfishtë, Persona pjesë e Komunitetit Egjyptian, Përfitimet e grupit të synuar lidhen kryesisht me:

Përmirësimi i qasjes në shërbime sociale përmes rritjes së numrit dhe llojeve të shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë. (Qëllimi 2 në planin social). Për të kontribuar në arritjen e këtij qëllimi ky projekt ka dy objektiva specifike:

Objektivi 1: Të ngrihet dhe të vihet në funksion qendra ditore e të moshuarve duke ofruar shërbime për të moshuarit dhe grupet në nevojë. (Shërbimet do të ofrohen për të moshuarit e vetmuar, personat me aftësi të kufizuara, personat në situatë vulnerabiliteti të shumëfishtë.)

Objektivi 2.3 në Planin Social

Objektivi 2: Të rrisë përfshirjen sociale të moshës së tretë dhe grupeve në nevojë në qytetin e Përmetit nëpërmjet realizimit të aktiviteteve social-kulturore.

Hapat e ndjekur për procesin e përzgjedhjes së individëve përfitues:

1. Me nisjen e implementimit të projektit, referuar dhe zbatimit të projektit për të moshuarit që Bashkia Përmet po zbaton me UNDP, një tablo e përgjithshme e situatës dhe nevojave të komunitetit është krijuar.
2. Bashkia Përmet vijoi bashkëpunimin me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Përmet për bashkëpunimin e stafit të dy institucioneve gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit dhe jo vetëm. Fillimisht konsultimi me mjekët e familjes nga Njësia e Referimit të Rastit në Bashki për të mbledhur nevoja të tjera.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

3. Gjatë aplikimit të projektit, Bashkia i është referuar situatës së Pandemisë Covid 19 dhe problematikave apo kërkesave të komunitetit për cdo kategori dhe referuar Planit Social të Bashkisë Përmet 2024-2027 për kategoritë prioritet për tu mbështetur.
4. Pas disa takimeve me Grupin e Punës për zbatimin e projektit i ngitur me Urdhër Nr.46 datë 12.02.2025, Nr.422 Prot datë 12.02.2025, përcaktuam kriteret për të moshuarit që do të përzgjidheshin bazuar edhe në synimin dhe objektivat e Projektit, referuar edhe Planit Social, kategoria që do të ishte prioritet do të ishte:
 - Të moshuar të vetmuar që jetojnë pa asnjë të afërm pranë
 - Individë pjesë e Komunitetit Egjyptian (të vetmuar+ vështirësi ekonomike)
 - Individë që trajtohen me PAK pa mbështetje
 - Individë PAK dhe në situatë rruge
 - Individë me vështirësi ekonomike
5. Grupi i punës ka marrë në konsideratë dhe rastet e identifikuar dhe referuara nga Shërbimi Social Shtetëror.
6. Duke marrë parasysh që shërbimi do të ofrohet në Qendrën Ditore pranë Konviktit Përmet, lista e përfituesve do të fokusohet për kategoritë në nevojë që jetojnë në qytet.
7. Pas disponimit të një liste me rreth 40 individë, kemi arritur në listën përfundimtare me 30 individë, numër ky i përcaktuar në projekt si përfitues të shërbimeve.
8. Konsultimi përfundimtar arriti në emrat e mëposhtëm:

Nr	Emer	Mbiemer	Pozicioni
1	Kujtim	Xhaferri	P.A.K, vështirësi ekonomike, i vetmuar
2	Vezire	Duralliu	Pensionist i vetmuar, Komuniteti Egjyptian, vështirësi ekonomike
3	Elsa	Xhoxhi	Pens.e vetmuar, vështirësi ekonomike
4	Jorgo	Xhavara	Pens.te vetmuar, vështirësi ekonomike
5	Eldi	Petro	P.A.K, i vetmuar, vështirësi ekonomike
6	Durim	Elmazi	PAK, i pastrehë
7	Dituri	Zeneli	P.A.K, Komuniteti Egjyptian, vështirësi ekonomike
8	Flutura	Zeneli	P.A.K, Komuniteti Egjyptian, vështirësi ekonomike
9	Zenel	Zeneli	P.A.K, Komuniteti Egjyptian, vështirësi ekonomike
10	Apostol	Dhiamanti	I vetmuar ne nevoje, i pastrehë
11	Filip	Tyto	I vetmuar, PAK, vështirësi ekonomike
12	Zoge	Naqe	Pensioniste vetmuar, vështirësi ekonomike
13	Marjeta	Çako	Invalide, vështirësi ekonomike
14	Kostandin	Papa	I vetmuar, vështirësi ekonomike, papërkrahje
15	Anxhelo	Zeqiri	I vetmuar, Komunitet egjyptian, pa të ardhura
16	Spartak	Jemini	P.A.K, jetim, vështirësi ekonomike
17	Jorgo	Jemini	P.A.K, jetim, vështirësi ekonomike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

18	Florand	Beqaraj	PAK, vështirësi ekonomike
19	Vali	Nika	Në gjendje të vështirë ekonomike
20	Liri	Çumani	Komuniteti Egjyptian, Ne gjendje te veshtirë ekonomike
21	Kastriot	Koto	I pastrehë, i vetmuar, ne gjendje te veshtire ekonomike
22	Anastas	Qorri	Pensionist i vetmuar
23	Evgjeni	Bushi	Pensioniste e vetmuar ne gjendje te veshtire ekonomike
24	Fatmira	Beqaraj	Familje ne kushte ekstreme te varfera
25	Lulezim	Beqaraj	Familje ne kushte ekstreme te varfera
26	Fatjon	Beqaraj	Familje ne kushte ekstreme te varfera
27	Shpresa	Jaupaj	Gjendje e veshtirë ekonomike, sëmundje shoqëruese
28	Koço	Tinko	Pensionist i vetmuar
29	Dashnor	Pelushaj	Familje ekstremisht e varfer
30	Gentian	Çaushaj	Familje me vështirësi ekonomike

Kjo është lista përfundimtare për miratim nëse nuk do të ketë sugjerime nga Komisioni i Përkrahjes Sociale apo antarët e Këshillit Bashkiak.

Faleminderit
Drejtorja e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte
Arjana Papapano

Drejtorja e Projekteve të Huaja/ Integritimit Evropian / Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave

Klaudja Ciko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ .2025

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR
BASHKËPUNIMIN NDËRKUFITAR AOS-VJOSA

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar si dhe bazuar në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë ,

VENDOSI :

1. Të miratojë memorandumin e mirëkuptimit për bashkëpunimin ndërkufitar aos-vjosa
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social/arsim/kulturë/sport.
3. Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

RELACION

PËR

**PËR MIRATIMIN E E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR
BASHKËPUNIMIN NDËRKUFITAR AOOS-VJOSA**

Referuar marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Greke për krijimin e komisionit të përhershëm Shqiptaro-Greko për çështjet ndërkufitare të ujërave të ëmbla -3.04.2003 kërkohet të firmoset një memorandum mirëkuptimi ku palët do të bashkëpunojnë për mbrojtjen e lumit ndërkufitar "Vjosa", i cili rrjedh nëpër territoret e tyre.

Ky memorandum bashkëpunimi është i një rëndësie të veçantë për faktin se objekti i saj konsiston në mbrojtjen e lumit Vjosa i cili është me rëndësi ndërkombëtare dhe palët pranojnë në këtë mënyrë përgjegjësinë e përbashkët në menaxhimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve ujore.

Si objektivi i memorandumit të bashkëpunimit palët synojnë të shkëmbejnë informacion dhe praktikat më të mira për menaxhimin e ujërave të zeza, ruajtjen e mjedisit dhe reduktimin e menaxhimit të mbetjeve. Veprimet që duhen marrë nga ana e Bashkisë Përmet lidhen me: rritjen e bashkëpunimit për shmangien e rrezikut nga përmytjet, të marrin pjesë në konsultimet publike për planet e menaxhimit të ujëmbledhëse ndërkufitare lumore dhe planet e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet dhe forcimin e masave për menaxhimin e ujërave të zeza.

Memorandumi kërkohet të lidhet për një afat 5 vjeçar.

Bashkëlidhur do të keni një kopje të memorandumit.

Konceptoi :Ketrina Lile





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Datë _____._____.2025

P/VENDIM

PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI SHKURT 2025

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore “i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike”,VKM Nr617 datë 22.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,”Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. VKB nr.107 datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj ”Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

VENDOSI

1.Të perfitojne ndihme ekonomike për Muajn **SHKURT 2025**, **33** familje me një fond **113.000** lekë.

2.Fondet të përballohen nga struktura :

1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.01.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 113.000 lekë

3. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma/leke
1	Ziso Apostol Kristo	Valentina Polikron Kristo	3	3600
2	Xhilda Xhemal Selimllari	Xhilda Xhemal Selimllari	2	3500
3	Mitro Gani Zeqiri	Lefteri Rrapi Zeqiri	4	4600
4	Syrja Mehmet Hoxha	Beqar	1	3200
5	Drita Irakli Kosta	Divorcuar	2	2900
6	Lefteri Polikron Proko	E ve	1	3600
7	Andon Dhimitraq Kukureci	I ve	2	3800
8	Aferdita Nuredin Lahe	Beqare	1	2400
9	Arben Thoma Teka	Mirela Xheli Teka	6	5400
10	Viktor Josif Proko	Divorcuar	1	2400
11	Dhimo Naun Dimçi	Lindita Hysen Dimçi	3	3600
12	Vera Thanas Naçe	E ve	2	2900
13	Leonart Petro Markaj	Kristina Petraq Markaj	3	3300

14	Thoma Aristidh Ilia	Maria Nuredin Ilia	4	4600
15	Xhensila Maksim Jahjaj	Beqare me Femijë	2	3400
16	Violeta Guce Pelushi	Beqare	1	2400
17	Engjellushe Manxho Canollari	E ve	1	3600
18	Rivelino Fatmir Doko	Hurma Leonidha Doko	4	4600
19	Bajame Fari Hysenshahaj	E ve	1	2400
20	Lida Koco Thomollari	Divorcuar	1	3200
21	Vasilika Bedri Malka	E ve	2	3200
22	Ilir Sali Jashari	Beqar	1	2400
23	Vitori Llazo Caci	Beqare	2	2900
24	Luam Ferit Zeneli	Gezime Tafil Zeneli	4	4600
25	Ilber Kudret Dalipaj	Divorcuar	1	2400
26	Kastriot Kristo Koto	Kastriot Kristo Koto	3	4200
27	Kastriot Astrit Male	Divorcuar	1	2700
28	Vangjush Thanas Mamillo	Gentiana Seit Mamillo	3	4200
29	Bari Avni Zaimi	Valbona Zenel Zaimi	2	2900
30	Kadri Petrit Maska	Beqar	1	3200
31	Dashnor Guçe Pelushaj	Vezire Ali Pelushaj	4	4600
32	Klodiana Kristofor Peçi	Divorcuar	1	2700
33	Lulëzim Barjam Beqari	Divorcuar	1	3600
	SHUMA			113.000

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Sektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Datë ____ . ____ .2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI SHKURT 2025

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë.20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe shërbimet shoqërore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike", VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave," Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore, të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit të bashkise per vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punojseve të bashkise, institucioneve në varesi të saj "Familje të cilat janë përfituese në fondin e bashkise janë ato familje të cilat mbasi kanë bërë aplikimin në Sistemin e Ndiemes ekonomike, rekomandimin në fondin 6% nuk janë fituese. Dhe nga vizitat e kryera në familje duke parë gjendjen ekonomike të këtyre familjeve të cilat janë në gjendje të dobët ekonomike u arsyetua që të përfshihen në fondin e familjeve në nevojë dhe ritjen e pagesës mujore të këtyre familjeve bazur mbi ritjen e fondit të familjeve në nevojë për vitin 2025. Familje të cilat janë me një antar në listpagesë do të përfitojnë 600 lekë mbi pagesën që kanë aktualisht dhe familje të cilat janë me më shumë se një antar në listpagesë do të përfitojnë nga 400 lekë për çdo antar mbi pagesën që kanë aktualisht.

Përsa me sipër rekomandojmë të ndihmohen për muajin Shkurt 33 familje me një vlerë prej 113.000 lekë.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____, 2025

P/VENDIM

Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmës ekonomike, deri në 6% .

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmen dhe shërbimet shoqerore " i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 "Per disa ndryshime ne Vendimin 597 dt.04.09.2019 të K.M."Për percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmës ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perdituesar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.107 date 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe percaktimin e numrit te punojseve të bashkise, institucioneve në varesi të saj". Keshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë:

VENDOSI

1.Të perfitojnë ndihme ekonomike per Muajn Janar 2025, 6 familje me një fond prej 21.184 lekë.

2. Familjet që perfitojne jane si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma
1	Ylli Guçe Pelushaj	Zylkade Qerim Pelushaj	2	3.703
2	Roland Petraq Jorgji	Divorcuar	1	2.178
3	Lame Enver Ferati	Silvana Kujtim Ferati	3	5.227
4	Mimoza Skënder Gjoka	Divorcuar	1	2.178
5	Lefteri Mihal Tyto	Divorcuar	1	5.720
6	Flavia Musa Pelushaj	Beqare	1	2.178
	SHUMA			21.184

3..Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmes ekonomike.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA



1-10-1914



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Datë __. __. 2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËS
EKONOMIKE, DERI NË 6% .

Mbështetur në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”Ligjit 935 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”I ndryshuar me VKM Nr.955 datë 07.12.2016(kreu II pika 13)dhe udhëzimi nr.5 datë 17.02.2017 pika 2 i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.Për përcaktimin kriterëve,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe VKM nr.85 dat10.02.2021,nr.868,datë 29.12.2021;nr.617,datë 22.09.2022 i përditësuar Vendimi i,Këshillit Bashkiak Përmet me fonde të Buxhetit Vendor Nr.107 datë 18.02.2024”Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë,institucioneve në varësi të saj “Këshilli Bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,deri 6% të bllok ndihmës ekonomike të muajit.Janar 2025 me Vendim të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Socail Gjirokastër.Nr.10/2022 datë 27/10/2022 për dhënien e NE për periudhën 01-31-2025 Për Bashkinë Përmet.(Sipas vendimit të Muajit Janar 2025).

Për sa më sipër vlera e fondit të kushtëzuar (bllok ndihma ekonomike) për Muajin Janar 2025

është 52 familje me,Shumën prej 384.035 lekë dhe për tu trajtuar familje me ndihmë ekonomike janë në dispozicion 6% e këtij fondi ose 23.042 lekë,për Muajin Janar 2025.

Mbështetur në të dhënat për dhënien e Ndihmës Ekonomike për periudhën 1-31 Janar 2025 kanë aplikuar 7 familje nuk ka dalë asnjë familje fituese 52 janë përfituese në skemën e Ndihmës Ekonomike.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikuesve që nuk kane marë pikët e mjaftueshme për periudhën 01 Janar deri më datën 31 nga vlersimi I SH.S.SH rekomandojmë:

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar prej 6%,6 familje me një vlerë 21.184 lekë,nga ku fondi 6% në total sipas vendimit është në Shumën 23.042 difernca prej 1.858 lekë do të mbetet e papërdorur për muajin Janar.Trajtohen dy individë me statusin jetimë. me 20.100 lekë,nga 10.500 lekë secili dhe tre individë viktima të dhunës në familje me 29.700 lekë nga 9.900 lekë secili sipas VKM Nr.868 datë 29/12/2021.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr _____ Prot

Përmet, më __. __. 2025

**LËNDA: RAPORT PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR VITIN
2024 DHE TRASPARENCËN NË PROCESIN E VENDIMMARRJES**

E nderuar Kryetare e Bashkisë Përmet!

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, si dhe duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore, duke punuar bazuar në parimet e interesit publik, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Këshilli i Bashkisë Përmet, gjatë vitit 2024 ka patur si qëllim miratimin e vendimeve që i përkasin shërbimit ndaj qytetarëve, zhvillimit të qytetit, mbështetjes dhe promovimit të turizmit me ndihmë ekonomike dhe vendimet me karakter ekonomik që kanë të bëjnë me:

1. Zbatimin e buxhetit për vitin 2024, projektet e propozuara nga ekzekutivi për përmirësimin e shërbimeve dhe investimet.
2. Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, jo vetëm nga fondi i kushtëzuar, por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Përmet si më poshtë:

Nr.	Muaji	Ndihmë ekonomike për familje nga të ardhurat e Bashkisë	Ndihmë ekonomike nga Fondi për i kushtëzuar 6 %
-----	-------	---	---



1	Janar	31	9
2	Shkurt	31	9
3	Mars	31	9
4	Prill	31	9
5	Maj	31	9
6	Qershor	31	9
7	Korrik	31	9
8	Gusht	31	9
9	Shtator	31	9
10	Tetor	31	9
11	Nëntor	31	9
12	Dhjetor	31	9

Krahas këtyre vendimeve janë miratuar vendime për :

- Shtesë dhe ndryshime të buxhetit për vitin 2024 me qëllim rritjen e efikasitetit të burimeve financiare dhe përdorimin e tyre në shërbim të komunitetit, zhvillimit urban dhe rural, rritjes së investimeve dhe mbështetjes së ekzekutivit në projektet e fituar me fonde të BE, Qeverisë, dhe donatorë të huaj.
- Buxhetin e vitit 2024 dhe projekt-buxhetin afatmesëm të Bashkisë Përmet për vitet 2024-2026.
- Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Përmet për vitin 2024.
- Dhënien e titujve "Qytetar Nderi bazuar në kërkesat dhe trajtimin e dy komisioneve.
- Bursat për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe konviktet e shkollave të mesme profesionale, për vitin shkollor 2023-2024 , si dhe mbështetjen e nxënësve ekselentë të etj.

Për periudhën janar – dhjetor 2024 janë marrë 122 vendime në Këshillin Bashkiak Përmet.

- Vlen për tu theksuar se nga 122 vendime të marra 54 vendime kanë kërkuar konfirmimin e Prefektit të Qarkut nga të cilët 53 vendime janë konfirmuar.
- Vendimet me karakter normativ kanë pasur të bëjnë me buxhetin dhe zbatimin e tij, përmirësimin e shërbimeve, detajimin e shpërndarjes së buxhetit etj..
- mbështetjen e projekteve të fituara nga ekzekutivi, planet vendore për pastrimin, mbrojtjen nga zjarri, planet sociale të bashkisë si dhe vendimet për mbështetjen e familjeve që kanë patur dëmtime të banesave të tyre nga zjarri.
- vendimet të cilat janë me karakter personal, 24 prej tyre kanë të bëjnë me dhënien e ndihmës ekonomike sipas muajve, vendime për miratimin e listës së përfituesve të subvencionit të qirasë dhe subvencionit të kredisë, vendime për shtyrjen e afatit të kredisë si dhe për vendosjen në Shtëpinë e të Moshuarve si dhe titujt e nderit.



- Për vitin 2024 janë dhënë 12 tituj Nderi .

Këto vendime të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të qytetit të Përmet dhe njësive administrative.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qënë mjaft aktiv, duke mbajtur 16 mbledhje te radhës dhe 3 mbledhje jashtë radhe.

Vlen për tu përmendur se pjesëmarrja e këshilltarëve ka qënë aktive si në mbledhjet e komisioneve ashtu dhe në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare online apo ato fizike . Komisionet e përhershme të këshillit janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar projekt vendime te sjella nga administrata e Bashkisë Përmet që kanë të bëjnë sidomos me vendimet me karakter ekonomik, titujt e nderit, çeshtje juridike etj

Për periudhën 12-mujore janë bërë 9 mbledhje të komisioneve.

Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në vendime për:

- 1. financiare**
- 2. sociale**
- 3. infrastrukturën dhe strehimin**
- 4. problemet urbane dhe asetet**
- 5. emergjencat civile**
- 6. probleme të arsimit kulturës**
- 7. trajtimi i mbetjeve**
- 9. planet lokale**

Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i ankesave/kërkesave dhe një regjistër fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit të Bashksië. Konkretisht jane depozituar në total 17 kërkesa drejtuar këshillit Bashkiak Kërkesat janë trajtuar dhe janë koordinuar me ekzekutivin e bashkisë dhe në të gjitha rastet janë informuar qytetarët.

Është pasuruar faqja online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun nëpërmjet kartelave të mëposhtëme :

Rreth Këshillit Bashkiak

Struktura e Këshillit Bashkiak

Anëtarët e Këshillit Bashkiak
Vendime të Këshillit Bashkiak.
Komisionet e Këshillit

Regjistri elektronik i kërkesave, ankesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare.
duke rritur nivelin e transparencës së këshillit.

Vendimet e Këshillit, procesverbalet e mbledhjeve, njoftimet dhe rendi i ditës janë transparente dhe qytetarët mund t'i gjejnë në ndërfaqen e Këshillit të webi të Bashkisë.

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014. "Për konsultimin Publik" gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, Këshilli në bashkëpunim me ekzekutivin marrë pjesë në 10 dëgjesa publike që kanë të bëjnë me hartimin e Paketës Fiskale, me zbatimin e buxhetit për vitin 2024 dhe kërkesat buxhetore për vitin 2025, përsa i përket miratimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025, të buxhetit të Bashkisë Përmet për vitin 2025 si dhe projekt-buxhetit afatmesëm të Bashkisë Përmet për vitet 2025-2027.

Këshilli ka marrë pjesë në seanca dëgjimore së bashku me administratën e Bashkisë ku janë mbajtur shënime mendimet dhe opinionet e pjesëmarrësve dhe i janë përcjellë Komisionit të Ekonomisë, Buxhetit dhe Ligjeve.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si: diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, zbatimi i standardeve e rregulloreve etj. me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit, ku çdo këshilltar për aktet normative, të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë me qëllim që vendimmarrja të jetë në shërbim të komunitetit.

Gjatë mbledhjeve të Këshillit Bashkiak kështillarët kanë shprehur kërkesa dhe ankesa të qytetarëve të zonave që përfaqësojnë të cilat i janë parashtruar ekzekutivit dhe janë diskutuar më tej për të marrë zgjidhje rast pas rasti.

Për sa më sipër ju falenderojmë secilin për kontributin e dhënë dhe ju ftojmë të jepni mendimet dhe sugjerimet tuaja për përmirësimin e punës së këshillit.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI

